

**UNIVERSITETI I EJL**  
**ЈИЕ УНИВЕРЗИТЕТ**  
**SEE UNIVERSITY**



**Fakulteti Juridik**  
**Правен Факултет**  
**Law Faculty**

**STUDIME PASDIPLOMIKE - CIKLI I DYTË**

**TEZA:**

**ASPEKTET KUSHTETUESE, LIGJORE DHE PRAKTIKE TË ZGJEDHJEVE TË  
SHTATA LOKALE TË TETORIT 2021 NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË  
VERIUT**

**KANDIDATJA:**  
**Alejna MEMEDI**

**MENTORI:**  
**Prof. Dr. sc. Jeton SHASIVARI**

**Tetovë, qershor 2022**

## PËRMBAJTJA

FALËNDERIMET .....	5
ABSTRAKT.....	8
HYRJA.....	9
KAPITULLI I PARË .....	144
ANALIZA E MODELIT TË ZGJEDHJEVE LOKALE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT .....	144
1.1 Modeli i zgjedhjeve lokale i Republikës së Maqedonisë së Veriut .....	144
1.2. Organet për realizimin e zgjedhjeve lokale.....	155
1.3. E drejta aktive dhe pasive e votës në zgjedhjet lokale .....	177
1.4. Papajtueshmëria e funksionit të kryetarit të komunës dhe e këshilltarit komunal me funksionet e tjera.....	17
1.5. Numri i këshilltarëve komunalë në Republikën e Maqedonisë së Veriut.....	211
1.6. Procedura e kandidimit dhe fushata parazgjedhore .....	232
1.7. Mbikëqyrja e zgjedhjeve lokale.....	23
KAPITULLI I DYTË .....	244
HISTORIKU I ZGJEDHJEVE LOKALE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT .....	244
2.1. Zgjedhjet e para lokale të v. 1996.....	244
2.2. Zgjedhjet e dyta lokale të v. 2000 .....	2626
2.3. Zgjedhjet e treta lokale të v. 2005 .....	27
2.5. Zgjedhjet e pesta lokale të v. 2013 .....	28
2.6 Zgjedhjet e gjashta lokale të v. 2017 .....	301
KAPITULLI I TRETË .....	322
ANALIZA LIGJORE DHE PRAKTIKE E ZGJEDHJEVE LOKALE TË TETORIT 2021 NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT DHE REZULTATET E TYRE .....	322
3.1. Përgatitja e zgjedhjeve lokale të tetorit 2021.....	322
3.2. Ndryshimet e fundit ligjore përkitazi me zgjedhjet lokale të tetorit 2021 .....	344
3.3. Pjesëmarrësit në zgjedhjet lokale të tetorit 2021.....	36
3.3.1. Partitë politike dhe koalicionet.....	37
3.3.1.1. VMRO-DPMNE .....	39
3.3.1.2. Bashkimi Demokratik për Integrim .....	400

3.3.1.3. Lidhja Socialdemokrate e Maqedonisë.....	400
3.3.1.4. Aleanca për Shqiptarët .....	411
3.3.1.5. Partia Alternativa .....	411
3.3.1.6. Lëvizja BESA .....	422
3.3.1.7. Levica .....	423
3.4. Fushata parazgjedhore e zgjedhjeve lokale e periudhës nga 27 shtatori deri 15 tetori 2021 dhe financimi i saj .....	43
3.5. Rezultatet e zgjedhjeve lokale të tetorit 2021.....	46
3.5.1. Rezultatet e zgjedhjeve lokale për kryetarë komunash në nivel të 80-të komunave .....	47
Rezultatet e zgjedhjeve lokale për kryetarë komunash në nivel të 80-të komunave .....	46
3.5.2. Rezultatet e zgjedhjeve lokale për këshilltarë komunalë në nivel të 80-të komunave .....	47
Rezultatet e zgjedhjeve lokale për këshilltarë komunalë në nivel të 80-të komunave (mbi 10-të këshilltarë) .....	47
3.5.3. Rezultatet e zgjedhjeve lokale për Kryetar të Qytetit të Shkupit .....	48
Rezultatet zgjedhore për Kryetar të Qytetit të Shkupit në raundin e parë zgjedhor .....	480
Rezultatet zgjedhore për Kryetar të Qytetit të Shkupit në raundin e dytë zgjedhor .....	490
3.5.4. Rezultatet e zgjedhjeve lokale për këshilltarë komunalë në Këshillin e Qytetit të Shkupit .....	490
Rezultatet e zgjedhjeve lokale për këshilltarë komunalë në Këshillin e Qytetit të Shkupit .....	490
3.5.5. Jehona e zgjedhjeve lokale të tetorit 2021 dhe analiza krahasimore me zgjedhjet paraprake lokale .....	500
Jehona e shtatë zgjedhjeve lokale në RMV-Raundi i parë.....	500
3.6. Mbrojtja juridike e së drejtës zgjedhore në zgjedhjet lokale të tetorit 2021 .....	500
3.7. Vlerësimet e zgjedhjeve lokale të tetorit 2021 .....	53
KONKLuzionET .....	57
BIBLIOGRAFIA.....	64

## DEKLARATË

Unë, Alejna Memedi deklaroj dhe vërtetoj se unë jam autori origjinal i këtij punimi të magistraturës me titull: *“Aspektet kushtetuese, ligjore dhe praktike të zgjedhjeve të shtata locale të tetorit 2021 në Republikën e Maqedonisë së Veriut”* dhe se të gjitha referencat si dhe citimet e marrura nga burimet e ndryshme materiale apo elektronike janë të shënuara me fusnota në fund të çdo faqeje si dhe në fund të këtij punimi. Me këtë rast, poashtu deklaroj se Universitetit ia barti të gjitha të drejtat autoriale të këtij punimi, për qëllime edukative-arsimore dhe hulumtuese.

Qershor 2022

Alejna Memedi, ID 127018

## FALËNDERIMET

Falënderoj të gjithë ata që kontribuan në përfundimin e këtij studimi, veçanërisht Zotin i cili më ka mbrojtur dhe më ka dhënë mundësinë që ta realizoj qëllimin tim. Gjithashtu unë nuk do të kisha patur mundësinë që ta kryej këtë tezë masteri pa udhëzimet e anëtarëve të komisionit, përkrahjes nga familja ime dhe ndihma që më është ofruar nga të afërmit dhe shoqëria ime.

Do të doja të shprehja mirënjohjen më të thellë për mentorin e tezës time të magistraturës Prof. Jeton Shasivari i cili ka qenë i jashtëzakonshëm dhe më ka udhëzuar dhe ndihmuar tejmasë në këtë rrugëtim.

Entuziazmi, kurajoja, kujdesi dhe durimi i tij gjatë kësaj kohe për mua kanë qenë shumë profitabile. Ai ishte pozitiv, gjithmonë i gatshëm për t'iu përgjigjur pyetjeve të mia dhe nuk hezitonte të më udhëzonte drejt burimeve të duhura.

Unë ofroj vlerësimin më të lartë për durimin dhe korrigjimin e shkrimeve të mia sa herë që unë kisha nevojë. Përveç kësaj, unë falënderoj edhe të gjithë profesorët e mi të mëparshëm për mundin dhe përpjekjet e tyre që nga shkolla fillore e deri në studimet themelore dhe pasdiplomike.

U jam shumë në borxh prindërve të mi të cilët dhanë mund dhe bënë shumë sakrifica për të arritur këtë sukses.

Gjithashtu falënderim i veçantë shkon edhe për kolegët, shoqërinë, emrat e të cilëve nuk do të bëhen publike, por përpjekjet e tyre do të vlerësohen nga unë gjithmonë.

Përveç kësaj, kompletimi i këtij hulumtimi nuk do të kishte qenë i mundur pa përkrahjen e familjes sime: prindërve të mi, si dhe të gjithë anëtarëve tjerë të familjes sime.

Ndihesha shumë komfort kur e dija se ata do të luteshin dhe do të më përkrahnin mua gjatë gjithë kësaj kohe. Kurajo që ata më jepnin mua kur ndonjëherë gjërat më përkeqësoheshin do të çmohen përgjithmonë nga ana ime.

U jam shumë në borxh për përkrahjen e tyre emocionale, morale, financiare si dhe për dashurinë dhe kujdesin ndaj meje. Ata meritojnë dashurinë e pastër dhe falënderimin më të thellë.

### **ABSTRAKTI**

Në përgjithësi, supozohet se politika vendore nuk ka nevojë për alternativa partiake apo politike, por zgjidhjet më të mira profesionale për problemet lokale, gjë që vërtetohet më qartë nga pjesëmarrja në zgjedhje: sa më të larta të jenë zgjedhjet hierarkike, aq më e lartë është edhe pjesëmarrja në votues, me pjesëmarrje më të dobët në zgjedhjet lokale që shoqërohet me interesim më të dobët për politikën lokale, njohuri më të dobëta të politikanëve vendorë dhe përmbajtjen e politikës lokale, dhe besim më të dobët në institucionet politike lokale, veçanërisht organizatat e partive politike lokale.

Prandaj, zgjedhjet lokale zakonisht quhen: zgjedhje me stimul të ulët, me nënkuptimin se, nga ky rregull ka përjashtime, që lidhen me ngjarje të jashtëzakonshme ose situata të veçanta konflikti, ku zgjedhjet vendore mund të kenë një stimul të lartë.

Lidhur me këtë, duke pasur parasysh faktin se pushteti politik fitohet në zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale, vlen të theksohet se këto pikëpamje dhe tipare teorike të zgjedhjeve lokale zakonisht i hasim në praktikën zgjedhore të Maqedonisë së Veriut, ku zgjedhjet nacionale (zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale) janë më të rëndësishme se zgjedhjet lokale, por nga ky fakt nuk duhet të nxjerrim përfundimin e gabuar se zgjedhjet lokale nuk kanë asnjë rëndësi politike apo shoqërore, pikërisht për faktin se zgjedhjet e fundit lokale të tetorit 2021 patën një rëndësi të madhe politike dhe shoqërore sepse rezultati i tyre shkaktoi dorëheqjen e kryeministrit Zoran Zaev. Ky përjashtim është mjaft i rëndësishëm sepse zgjedhjet e fundit lokale të tetorit 2021, praktikisht treguan një pasqyrim të zgjedhjeve nacionale, ku votuesit shprehën kryesisht mbështetje ose mosbesim ndaj qeverisjes së vendit, ku sjellja politike e votuesve u ndikua thelbësisht nga identifikimi partiak sepse këto zgjedhje lokale kishin rolin e testimi politik të besimit të qeverisë së Maqedonisë së Veriut para qytetarëve.

**Fjalë kyçe:** E drejta e zgjedhjes, kodi zgjedhor, zgjedhjet lokale, pushteti lokal

## АПСТРАКТ

Општо земено, се претпоставува дека на локалната политика не и требаат партиски или политички алтернативи, туку најдобри професионални решенија за локалните проблеми, за што најјасно говори излезноста: колку се повисоки хиерархиските избори, толку е поголема излезност на гласачите, со послаба излезност на локалните избори придружена со помал интерес за локалната политика, послабо познавање на локалните политичари и содржината на локалната политика и послаба доверба во локалните политички институции, особено во организациите, локалните политички партии.

Затоа, локалните избори обично се нарекуваат: избори со низок стимул, што значи дека постојат исклучоци од ова правило, поврзани со вонредни настани или посебни конфликтни ситуации, каде што локалните избори може да имаат висок стимул.

Во таа насока, имајќи го предвид фактот дека политичката моќ се стекнува на парламентарни и претседателски избори, вреди да се истакне дека овие гледишта и теоретски карактеристики на локалните избори вообичаено се среќаваат во изборната практика на Северна Македонија, каде што националните избори (парламентарни и претседателски избори) се поважни од локалните избори, но од овој факт не треба да се извлече погрешен заклучок дека локалните избори немаат политичко или општествено значење, токму затоа што последните локални избори во октомври 2021 година беа од големо политичко и општествено значење бидејќи нивниот резултат го поттикна оставка на премиерот Зоран Заев. Овој исклучок е доста важен бидејќи последните локални избори од октомври 2021 година, практично покажаа одраз на националните избори, каде гласачите главно изразија поддршка или недоверба кон владата на земјата, каде политичкото однесување на гласачите беше суштински под влијание на партиската идентификација бидејќи Овие локални избори имаа улога на политички тест на довербата на владата на Северна Македонија пред граѓаните.

**Клучни зборови:** Избирачко право, изборен законик, локални избори, локална власт

## ABSTRACT

In general, it is assumed that local politics does not need partisan or political alternatives, but the best professional solutions to local problems, which is most clearly evidenced by turnout: the higher the hierarchical elections, the higher it is. voter turnout, with poorer turnout in local elections accompanied by lower interest in local politics, poorer knowledge of local politicians and the content of local politics, and weaker trust in local political institutions, especially organizations. local political parties.

Therefore, local elections are usually called: low-stimulus elections, meaning that there are exceptions to this rule, related to extraordinary events or special conflict situations, where local elections may have a high stimulus.

In this regard, given the fact that political power is gained in parliamentary and presidential elections, it is worth noting that these views and theoretical features of local elections are usually encountered in the electoral practice of Northern Macedonia, where national elections (parliamentary and presidential elections) are more important than local elections, but from this fact we should not draw the wrong conclusion that local elections have no political or social significance, precisely because the last local elections of October 2021 were of great political and social importance because their result prompted the resignation of Prime Minister Zoran Zaev. This exception is quite important because the last local elections of October 2021, practically showed a reflection of the national elections, where voters mainly expressed support or distrust of the government of the country, where the political behavior of voters was fundamentally influenced by party identification because these local elections had the role of politically testing the confidence of the government of North Macedonia in front of the citizens.

**Keywords:** Right to vote, electoral code, local elections, local government



## **HYRJE**

### **Lënda e hulumtimit**

Teorikisht, zgjedhjet lokale zakonisht përkufizohen si një proces politik zgjedhor që themelon organe përfaqësuese në komunitete të ndryshme lokale. Ato dallohen nga zgjedhjet nacionale për nga karakteristikat strukturore, procedurale dhe përmbajtësore, si dhe për nga ndikimi dhe rëndësia politike dhe shoqërore.

Megjithatë, dallimi kryesor ndërmjet tyre shprehet në hierarkinë zgjedhore si një shkallë në të cilën llojet individuale të zgjedhjeve renditen sipas rëndësisë së tyre për jetën e përgjithshme politike dhe shoqërore të një vendi. Hierarkia e përgjithshme e zgjedhjeve nënkupton supremacinë e zgjedhjeve nacionale, ku p.sh. në Gjermani zgjedhjet nacionale cilësohen si: zgjedhje parësore ndërsa zgjedhjet lokale si: zgjedhje dytësore, ndërsa në Itali zgjedhjet kombëtare quhen: zgjedhje politike, ndërsa zgjedhjet lokale si: zgjedhjet administrative.

Lënda e këtij hulumtimi është analiza e zgjedhjeve lokale të shtatë radhazi që nga pavarësia e Maqedonisë së Veriut, të cilat u mbajtën më 17 tetor 2021 (raundi i parë) dhe 31 tetor 2021 (raundi i dytë) në 80 komuna dhe në qytetin e Shkupit si njësi e veçantë e Vetëqeverisjes Lokale.

Në Maqedoninë e Veriut, modeli zgjedhor mazhoritar aplikohet për zgjedhjet e kryetarit të komunës, ndërsa modeli zgjedhor proporcional për zgjedhjet për anëtarët e këshillave komunale. Në këtë punim do të analizohen edhe ndryshimet e fundit në Kodin Zgjedhor në lidhje me mënyrën e votimit gjatë pandemisë Covid-19 si dhe mënyrën e përcaktimit të identitetit të zgjedhësve me gjurmë gishtash, e cila u aplikua për herë të parë në historinë e zgjedhjeve në përgjithësi në Maqedoninë e Veriut.

Në veçanti, rëndësia e veçantë e këtij punimi qëndron në faktin se, zakonisht çështja e zgjedhjeve lokale nuk është temë me interes të veçantë për shkencat juridike dhe politike në Maqedoninë e Veriut, sepse duke u nisur nga hierarkia strukturore, zgjedhjet nacionale (parlamentare dhe zgjedhjet presidenciale) zakonisht kanë një avantazh të konsiderueshëm

ndaj zgjedhjeve lokale, por me përjashtim të veçantë sepse zgjedhjet e fundit lokale të tetorit 2021 shkaktuan dorëheqjen e kryeministrit Zaev dhe zgjedhjen e Qeverisë së re të Maqedonisë së Veriut.

### **Qëllimet e hulumtimit**

Në përgjithësi, supozohet se politika vendore nuk ka nevojë për alternativa partiake apo politike, por zgjidhjet më të mira profesionale për problemet lokale, gjë që vërtetohet më qartë nga pjesëmarrja në zgjedhje: sa më të larta të jenë zgjedhjet hierarkike, aq më e lartë është edhe pjesëmarrja në votues, me pjesëmarrje më të dobët në zgjedhjet lokale që shoqërohet me interesim më të dobët për politikën lokale, njohuri më të dobëta të politikanëve vendorë dhe përmbajtjen e politikës lokale, dhe besim më të dobët në institucionet politike lokale, veçanërisht organizatat e partive politike lokale.

Prandaj, zgjedhjet lokale zakonisht quhen: zgjedhje me stimul të ulët, me nënkuptimin se, nga ky rregull ka përjashtime, që lidhen me ngjarje të jashtëzakonshme ose situata të veçanta konflikti, ku zgjedhjet vendore mund të kenë një stimul të lartë.

Lidhur me këtë, duke pasur parasysh faktin se pushteti politik fitohet në zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale, vlen të theksohet se këto pikëpamje dhe tipare teorike të zgjedhjeve lokale zakonisht i hasim në praktikën zgjedhore të Maqedonisë së Veriut, ku zgjedhjet nacionale (zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale ) janë më të rëndësishme se zgjedhjet lokale, por nga ky fakt nuk duhet të nxjerrim përfundimin e gabuar se zgjedhjet lokale nuk kanë asnjë rëndësi politike apo shoqërore, pikërisht për faktin se zgjedhjet e fundit lokale të tetorit 2021 patën një rëndësi të madhe politike dhe shoqërore sepse rezultati i tyre shkaktoi dorëheqjen e kryeministrit Zoran Zaev. Ky përjashtim është mjaft i rëndësishëm sepse zgjedhjet e fundit lokale të tetorit 2021, praktikisht treguan një pasqyrim të zgjedhjeve nacionale, ku votuesit shprehën kryesisht mbështetje ose mosbesim ndaj qeverisjes së vendit, ku sjellja politike e votuesve u ndikua thelbësisht nga identifikimi partiak sepse këto zgjedhje lokale kishin rolin e testimit politik të besimit të qeverisë së Maqedonisë së Veriut para qytetarëve.

## **Hipotezat e hulumtimit**

Gjatë hulumtimit shkencor do të paraqesim disa hipoteza të cilat gjatë përpunimit të tezës MA do të vërtetohen:

1. Sistemi zgjedhor në RMV është në përputhje me standartet ndërkombëtare dhe europiane.
2. Zgjedhjet e shtata lokale në RMV e kishin rolin e zgjedhjeve nacionale për shkak të dorëheqjes së Kryeministrit Zaev dhe ndryshimit të Qeverisë.
3. Kodi Zgjedhor i RMV-së i përmban të gjitha dispozitat e nevojshme ligjore për organizimin e zgjedhjeve lokale.
4. Zgjedhjet e shtata lokale në RMV ishin kredibile dhe kompetitive.
5. Partitë kryesore parlamentare gëzojnë avantazhe sistematike, veçanërisht në shpërndarjen e burimeve publike për fushatë, duke përfshirë edhe median.
6. Mungesa e temave reale lokale gjatë fushatës zgjedhore si dhe fushata e zezë denigruese ishin faktori kryesor që zgjedhjet e shtata lokale në RMV të kenë jehonën më të ulët zgjedhore në historinë e zgjedhjeve lokale në RMV.

## **Metodologjia e hulumtimit**

Në këtë punim të magjistraturës do të shfrytëzohet literaturë hulumtuese e ndryshme duke filluar nga tekstet universitare, studime, raporte dhe publikime të tjera që kanë të bëjnë me temën e caktuar, etj.

Metodat që do të përdoren janë :

- Metoda historike - do të përdoret kjo metodë që të hulumtohet historiku i zgjedhjeve lokale në Republikën e Maqedonisë së Veriut nga pavarësimi i saj e deri më sot respektivisht nga zgjedhjet e para lokale të v. 1996 e deri më sot.

- Metoda juridike – do të shqyrtohen dhe analizohen zgjedhjet dhe reformat ligjore të legjislacionit zgjedhor në RMV përkitazi me këto zgjedhje të shtata lokale në RMV.

- Metoda statistikore – do të shqyrtohen rezultatet zgjedhore e të gjithë pjesëmarrësve në këto zgjedhje.

-Metoda komparative – do të bëhen krahasimet e duhura të zgjedhjeve lokale në RMV mes vete si dhe të zgjedhjeve të ndryshme ligjore.

### **Rëndësia e hulumtimit**

Rëndësia e këtij hulumtimi qëndron në atë se elaborimi, analiza dhe rekomandimet e bëra në lidhje me sistemin zgjedhor për zgjedhjet lokale çdoherë janë të rëndësishme në një vend me sistem demokratik.

Çdo demokraci lokale ka nevojë që herë pas herë të testojë funksionalitetin dhe efikasitetin e institucioneve të saj lokale, e zgjedhjet lokale janë ato që pikërisht e mundësojnë këtë gjë. Si një prej instrumenteve më të rëndësishme të demokracisë lokale sot, zgjedhjet lokale shërbejnë si rrugë për pjesëmarrje të qytetarëve në procese politike lokale, duke i zgjedhur zyrtarët lokalë që përfaqësojnë më së miri vlerat dhe interesat e popullit, votuesit mund të ndikojnë në formësimin e politikave lokale publike që përmirësojnë kualitetin e jetës së tyre në komunat si njësi të qeverisjes lokale në RMV.

Në këtë punim do të analizohen edhe ndryshimet e fundit në Kodin Zgjedhor në lidhje me mënyrën e votimit gjatë pandemisë Covid-19 si dhe mënyrën e përcaktimit të identitetit të zgjedhësve me gjurmë gishtash, e cila u aplikua për herë të parë në historinë e zgjedhjeve në përgjithësi në Maqedoninë e Veriut.

Duke pasur parasysh faktin se pushteti politik fitohet në zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale, vlen të theksohet se këto pikëpamje dhe tipare teorike të zgjedhjeve lokale zakonisht i hasim në praktikën zgjedhore të Maqedonisë së Veriut, ku zgjedhjet nacionale (zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale ) janë më të rëndësishme se zgjedhjet lokale, por nga ky fakt nuk duhet të nxjerrim përfundimin e gabuar se zgjedhjet lokale nuk kanë asnjë rëndësi politike apo shoqërore, pikërisht për faktin se zgjedhjet e fundit lokale të tetorit 2021 patën një rëndësi të madhe politike dhe shoqërore sepse rezultati i tyre shkaktoi dorëheqjen e kryeministrit Zoran Zaev. Ky përjashtim është mjaft i rëndësishëm sepse zgjedhjet e fundit

lokale të tetorit 2021, praktikisht treguan një pasqyrim të zgjedhjeve nacionale, ku votuesit shprehën kryesisht mbështetje ose mosbesim ndaj qeverisjes së vendit, ku sjellja politike e votuesve u ndikua thelbësisht nga identifikimi partiak sepse këto zgjedhje lokale kishin rolin e testimit politik të besimit të qeverisë së Maqedonisë së Veriut para qytetarëve.

## KAPITULLI I PARË

### ANALIZA E MODELIT TË ZGJEDHJEVE LOKALE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

#### 1.1 Modeli i zgjedhjeve lokale i Republikës së Maqedonisë së Veriut

Modeli zgjedhor për zgjedhjet lokale në RMV është përcaktuar me Kodin zgjedhor, ku përcaktohet se, në Republikën e Maqedonisë së Veriut, zgjedhjet për kryetarë komunash në njësitë e vetëqeverisjes lokale zhvillohen sipas modelit zgjedhor të shumicës, ndërsa zgjedhjet për anëtarë të këshillave në njësitë e vetëqeverisjes lokale sipas modelit zgjedhor proporcional me çrast, zgjedhjet për kryetarë dhe anëtarë të këshillit mbahen çdo katër vjet, njëkohësisht në të gjitha njësitë, në gjysmën e dytë të tetorit dhe Kryetari i Kuvendit i shpall zgjedhjet me akt përkatës i cili publikohet në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”, ndërsa nga dita e shpalljes së zgjedhjeve deri në mbajtjen e zgjedhjeve nuk mund të kalojnë më shumë se 90 e më pak se 70 ditë, ku zgjedhja e kryetarit në njësitë e vetëqeverisjes vendore bëhet sipas modelit zgjedhor mazhoritar dhe për kryetar komune zgjidhet kandidati që ka fituar shumicën e votave në raundin e parë të votimit, nëse dalin së paku një e treta e zgjedhësve të regjistruar në Listën zgjedhore të njësisë përkatëse të vetëqeverisjes lokale por, nëse asnjëri nga kandidatët nuk i plotëson kushtet e kërkuara, zgjedhjet përsëriten në raundin e dytë për dy kandidatët që kanë marrë më shumë vota dhe, nëse në zgjedhje merr pjesë vetëm një kandidat dhe ai nuk fiton shumicën e kërkuar, procedura e zgjedhjes përsëritet kurse, raundi i dytë i votimit zhvillohet 14 ditë pas përfundimit të të parit dhe në raundin e dytë zgjidhet kandidati që ka marrë numrin më të madh të votave<sup>1</sup>.

Në zgjedhjen e këshilltarëve në vetëqeverisjen lokale përdoret modeli proporcional dhe ndarja e mandateve bëhet sipas formulës së D'Hondtit<sup>2</sup>. Sipas kësaj formule, numri i përgjithshëm i votave të fituara për listat e propozuara të kandidatëve pjesëtohet me serinë e pjesëtuesve 1, 2, 3 ... deri në numrin e anëtarëve të këshillit që zgjidhen në njësinë specifike të

<sup>1</sup> Për më tepër shih në: Kodi zgjedhor i RMV-së (Propozimi i tekstit të konsoliduar) në dispozicion në linkun: [https://drive.google.com/file/d/1Sa9L6emhxl2VaV\\_8d7oK3hJ6r1usnuY/view](https://drive.google.com/file/d/1Sa9L6emhxl2VaV_8d7oK3hJ6r1usnuY/view).

<sup>2</sup> Për më tepër mbi metodën e DHontit shih në: Jeton Shasivari, E drejta kushtetuese, Furkan-ISM, Shkup, 2020, fq. 285-288.

vetëqeverisjes lokale dhe kuotat e marra në këtë mënyrë renditen sipas madhësisë, duke marrë parasysh koeficientët më të mëdhenj sa janë zgjedhur anëtarë të këshillit dhe një listë e kandidatëve merr aq anëtarë këshilli sa ka kuotat më të mëdha nga ata që konsiderohen<sup>3</sup>.

## 1.2. Organet për realizimin e zgjedhjeve lokale

Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve së bashku me Komisionet Komunale të Zgjedhjeve dhe Komisionin Zgjedhor të Qytetit të Shkupit, këshillat zgjedhore dhe këshillat e posaçme zgjedhore për votim në vend janë organe zgjedhore të ngarkuara për zhvillimin e zgjedhjeve lokale; kështu Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ) përbëhet nga shtatë anëtarë të cilët zgjidhen nga Kuvendi me shumicë prej dy të tretave të numrit të përgjithshëm të deputetëve ndërsa mandati i anëtarëve zgjat nga dita e zgjedhjes nga Kuvendi deri në zgjedhjen e përbërjes së re të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, por jo më gjatë se dy vjet dhe Kuvendi shpall zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve në “Gazetën Zyrtare” dhe në shtypin ditor ku shpallja zgjat tetë ditë nga dita e publikimit<sup>4</sup>.

Komisioni për Zgjedhje dhe Emërime i Kuvendit përgatit draft listën e kandidatëve të regjistruar dhe ia dërgon Kuvendit. Nga kandidatët në listën e propozuar, partitë politike opozitare propozojnë një kryetar dhe dy anëtarë të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, ndërsa partitë në pushtet respektivisht në pozitë propozojnë një nënkryetar dhe tre anëtarë të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve. Nëse partitë politike nuk i paraqesin propozimet brenda tri ditëve pas marrjes së njoftimit, Kryetari, nënkryetari dhe anëtarët e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve ia propozojnë Komisionit për Zgjedhje dhe Emërime të Kuvendit. Kompetencat e KSHZ-së përfshijnë publikimin e Listës zgjedhore, e cila duhet të vihet në dispozicion të publikut brenda 15 ditëve nga data e shpalljes së zgjedhjeve. Inspektimi publik i Listës zgjedhore zgjat 20 ditë. KSHZ-ja ka një shërbim profesional që drejtohet nga Sekretari i Përgjithshëm dhe kryen punë profesionale-administrative dhe organizative-teknike.

<sup>3</sup> Për më tepër shih në: Kodi zgjedhor i RMV-së (Propozimi i tekstit të konsoliduar) në dispozicion në linkun: [https://drive.google.com/file/d/1Sa9L6emhxl2VaV\\_8d7oK3hJ6r1usnuY/view](https://drive.google.com/file/d/1Sa9L6emhxl2VaV_8d7oK3hJ6r1usnuY/view).

<sup>4</sup> Për më tepër për organet për realizimin e zgjedhjeve lokale shih në: Марко Панковски; Никола Михајловски; Ива Наскова; Здравко Ставров, Прирачник за локални избори во Република Северна Македонија 2021 година, Второ дополнето издание, декември 2021, КАС, Скопје, стр. 38-39.

Komisionet komunale të zgjedhjeve që formohen në nivel të secilës komunë dhe Komisioni zgjedhor i qytetit të Shkupit janë përgjegjës për zhvillimin e zgjedhjeve në territorin nën juridiksionin e tyre dhe mbikëqyrin punën e këshillave zgjedhorë. Ato përbëhen nga pesë anëtarë, njëri prej të cilëve është kryetar dhe secili prej anëtarëve ka një zëvendës. Anëtarët dhe zëvendësit e komisioneve zgjedhore komunale zgjidhen nga radhët e të punësuarve në shtetin, publik, komunal dhe administratën e Qytetit të Shkupit, me arsim të lartë, për një mandat prej pesë vjetësh. Përzgjedhja e tyre bëhet nga KSHZ-ja në mënyrë të rastësishme sapa të marrë të dhënat e administratës shtetërore dhe komunale, administratës së qytetit të Shkupit dhe administratës publike.

Këshilli Zgjedhor është organ që formohet për çdo qendër votimi, përbëhet nga pesë anëtarë, njëri prej të cilëve është kryetari dhe për secilin prej tyre zgjidhen deputetë. Kryetari i Këshillit zgjedhor dhe zëvendësi i tij, dy anëtarë dhe zëvendësit e tyre zgjidhen nga radhët e të punësuarve në shtetin, publik, komunal dhe administratën e Qytetit të Shkupit, me arsim të mesëm së paku të përfunduar, në mënyrë të rastësishme për një periudhë prej katër vjet. Një anëtar i KZ-së dhe zëvendësi i tij emërohen me propozimin e partive politike në opozitë që kanë fituar më shumë vota në zgjedhjet e fundit parlamentare dhe një tjetër me propozimin e partive politike në pushtet që kanë fituar më shumë vota në zgjedhjet e fundit parlamentare. Zgjedhjen e rastësishme të anëtarëve të këshillave zgjedhore (nga radhët e administratës) e bëjnë KKZ-të për zonën për të cilën janë kompetente, sipas aktit të mëparshëm të KSHZ-së, ndërsa, në ato komuna ku jetojnë së paku 20% e qytetarëve, pjesëtarë të komuniteteve joshumicë, zbatohet parimi i përfaqësimit adekuat dhe të drejtë në përbërjen e KKZ-ve dhe Këshillave Zgjedhor. Ligji parashikon gjithashtu një përfaqësim prej të paktën 30% të secilës gjini në përbërjen e organeve zgjedhore. Anëtarët e KKZ-ve dhe bordet zgjedhore nuk mund të zgjidhen apo emërohen nga zyrtarët e Qeverisë, Kuvendit dhe personat e punësuar në administratën shtetërore të Avokatit të Popullit, Ministrisë së Drejtësisë, Mbrojtjes, Punëve të Brendshme, Sekretariatit për Legjislacion, Entit Shtetëror të Statistikave, Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim, Qendra për Menaxhimin e Krizave, shërbimet eksperte të Gjykatës



Administrative, KSHZ-së, Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit dhe Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive<sup>5</sup>.

### **1.3. E drejta aktive dhe pasive e votës në zgjedhjet lokale**

Në zgjedhjet lokale në RMV, të drejtë vote ka çdo shtetas i RMV-së i cili ka mbushur moshën 18 vjeçare dhe i cili është ligjërisht i aftë dhe ka vendbanim të përhershëm në njësinë zgjedhore, komunën, përkatësisht qytetin e Shkupit ku mbahen zgjedhjet dhe votimi është i fshehtë dhe askush nuk duhet t'i kërkojë llogari zgjedhësit për votën, as t'i kërkojë atij ose asaj të thotë se për kë ka votuar ose pse nuk ka votuar ndërkaq, KSHZ-ja është përgjegjëse për informimin dhe edukimin e qytetarëve për mënyrën e votimit dhe ushtrimin e të drejtës së votimit, ndërsa në vendvotime dhe në ekranin e votimit shfaq udhëzimet për votim në maqedonisht, shqip, turqisht, vllahisht, serbisht, gjuha rome dhe boshnjake dhe në sallën e votimit afishohen edhe listat e kandidatëve ku kandidat për kryetar komune ose këshilli mund të jetë personi që ka mbushur moshën 18 vjeç dhe ka zotësi të veprimit ndërkaq, personi që është dënuar me dënim të formës së prerë me vendim të gjykatës për burgim pa kushte mbi 6 muaj, vuajtja e të cilit nuk ka filluar, ose është duke vuajtur dënimin për një krim, nuk mund të jetë kandidat për këto pozicione, kështu që, krahas këtyre kushteve, kandidati për kryetar komune ose anëtar këshilli duhet të ketë vendbanim të përhershëm në njësinë e vetëqeverisjes lokale për të cilën kandidon<sup>6</sup>.

### **1.4. Papajtueshmëria e funksionit të kryetarit të komunës dhe e këshilltarit komunal me funksionet e tjera**

Kjo çështje është rregulluar me pikën 6 dhe nenin 8 të Kodit zgjedhor të RMV-së.

---

<sup>5</sup> Për më tepër për organet për realizimin e zgjedhjeve lokale shih në: Марко Панковски; Никола Михајловски; Ива Наскова; Здравко Ставров, Прирачник за локални избори во Република Северна Македонија 2021 година, Второ дополнето издание, декември 2021, КАС, Скопје, стр. 38-39.

<sup>6</sup> Për më tepër shih në: Марко Панковски; Никола Михајловски; Ива Наскова; Здравко Ставров, Прирачник за локални избори во Република Северна Македонија 2021 година, Второ дополнето издание, декември 2021, КАС, Скопје, стр. 38-39.

Në këtë drejtim, funksioni deputet, anëtar i këshillit dhe kryetar i komunës është i papajtueshëm (jokoherent) me funksionin kryetar i RMV, kryetar i Qeverisë së RMV, ministër, gjykatës, prokuror publik, avokati publik, avokati i popullit dhe me bartës të tjerë të funksioneve që i zgjedh ose i emëron Kuvendi i RMV-së dhe Qeveria e RMV-së;

Funksioni deputet është jokoherent me funksionin kryetar komune dhe me anëtar të këshillit në komunë dhe në Qytetin e Shkupit;

Funksioni deputet dhe kryetar i komunës është jokoherent, me:

- kryerje të detyrave profesionale dhe administrative në organet e administratës shtetërore;

- kryerje të veprimtarisë ekonomike ose veprimtarisë tjetër fitimprurëse; dhe

- anëtarësimin në këshilla drejtuese të ndërmarrjeve publike, institucioneve publike, fondeve, agjencive, enteve dhe në personat tjerë juridikë, si dhe me zgjedhjen e përfaqësuesit të kapitalit shtetëror dhe shoqëror në shoqëritë tregtare;

Funksioni kryetar i Qytetit të Shkupit dhe funksioni anëtar i Këshillit të Qytetit të Shkupit është jokoherent me funksionin e kryetarit të komunës dhe funksionin anëtar i këshillit të komunave në rajonin e Qytetit të Shkupit;

Nga dita e miratimit të vendimit për shpalljen e zgjedhjeve deri në përfundimin e zgjedhjes për Kryetar të RMV, deputetë në Kuvendin e RMV dhe zgjedhjen e Qeverisë së RMV në pajtim me rezultatet e zgjedhjeve, si dhe nga dita e miratimit të vendimit për shpalljen e zgjedhjeve deri në përfundimin e zgjedhjeve për kryetar komune ose anëtarë të këshillit, përkatësisht deri në konstituimin e këshillit komunal dhe qytetit të Shkupit nuk mund:

- të fillojë ndërtimi me mjete nga buxheti ose nga fonde publike ose mjete të ndërmarrjeve publike dhe personave tjerë juridikë që menaxhojnë me kapital shtetëror, i objekteve të reja të infrastrukturës si rrugë, ujësjellës, largpërçues, kanalizim, terrene sportive dhe objekte tjera; ose objekte për veprimtari shoqërore, shkolla, kopshte feminare dhe objekte tjera, përveç nëse për këtë qëllim paraprakisht janë siguruar mjete nga buxheti, përkatësisht bëhet fjalë për realizimin e programit të miratuar në bazë të ligjit në vitin rrjedhës;

- të bëhen pagesa të rrogave, pensioneve, ndihmës sociale ose pagesa tjera dhe kompensime materiale nga mjete buxhetore ose nga mjete të fondeve publike që nuk janë

mjete pagesore të rregullta mujore, përkatësisht të gjitha transferet njëvjeçare dhe pagesa të transfereve të njëhershme nga mjete buxhetore ose nga mjete të fondeve publike, as të tjetërsohet kapitali shtetëror ose të nënshkruhen marrëveshje kolektive; dhe

- të fillojë procedurë për punësim, të personave të ri ose procedurë për ndërprerje të marrëdhënies së punës në institucione shtetërore dhe publike, ndërsa procedurat e filluara pezullohen, përveç në raste të punëve urgjente dhe të paprolongueshme;

Në periudhë prej 20 ditësh para fillimit të fushatës zgjedhore deri në përfundimin e zgjedhjes për Kryetar të Republikës së Maqedonisë, deputetë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë dhe zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë në pajtim me rezultatet e zgjedhjeve, si dhe nga dita e miratimit të vendimit për shpalljen e zgjedhjeve deri në përfundimin e zgjedhjeve për kryetar komune ose anëtarë të këshillit, përkatësisht deri në konstituimin e këshillit komunal dhe Qytetit të Shkupit nuk mund:

- të mbahen ngjarje publike me rastin e fillimit të ndërtimit ose lëshimit në përdorim të objekteve me mjete nga Buxheti ose fondet publike, ose me mjetet e ndërmarrjeve publike ose personave tjerë juridikë që menaxhojnë me kapital shtetëror, në infrastrukturat sikur rrugë, ujësjellës, largpërçues, kanalizim, terrene sportive ose objekte për veprimtari shoqërore, kopshte fëmimore si dhe objekte të tjera. Me ndalesën për mbajtje të ngjarjeve publike nuk nënkuptohet, veçanërisht: dhënie e deklaratës publike e bartësit të funksionit publik ose kandidatit për bartës të funksionit publik në miting, intervistë në media, debat në medie ose përgjigje të pyetjes së gazetarëve;

Nga dita e miratimit të vendimit për shpalljen e zgjedhjeve deri në përfundimin e zgjedhjes për Kryetar të Republikës së Maqedonisë, deputetëve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë dhe zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë në pajtim me rezultatet e zgjedhjeve, si dhe nga dita e miratimit të vendimit për shpalljen e zgjedhjeve deri në përfundimin e zgjedhjeve për kryetar komune ose anëtarë të këshillit, përkatësisht deri në konstituimin e këshillit komunal dhe qytetit të Shkupit, Ministria e Financave është e obliguar që të gjitha pagesat buxhetore, përveç rrogave të rregullta, pensionet dhe shpenzimet

komunale, t'i publikojë në faqen e internetit në bazë të veçantë të shpenzimeve buxhetore në periudhën zgjedhore<sup>7</sup>.

Ministria e Financave, dy javë pas shpalljes së zgjedhjeve parashtrohet raport parazgjedhor financiar në të cilin do të përfshihet pasqyrimi i të gjitha të hyrave dhe shpenzimeve të planifikuara dhe të realizuara nga Buxheti sipas zërave, në periudhën prej fillimit të vitit fiskal deri në ditën e parashtrimit të raportit që publikohet në ueb faqen e Ministrisë së Financave, me çrast për nevojat e fushatës zgjedhore, ndalohet shfrytëzimi i hapësirës së zyrave, pajisjeve për zyrë dhe mjeteve motorike zyrtare të organeve shtetërore, përveç për personat për të cilët vlejné dispozitat e veçanta për mbrojtje të personit dhe në afat prej dhjetë ditësh nga dita e miratimit të vendimit për shpallje të zgjedhjeve për Kryetar të Republikës së Maqedonisë së Veriut, deputetë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, kryetar të komunës ose anëtarë të këshillit, fondet publike, ndërmarrjet publike dhe të gjithë personat tjerë juridikë që menaxhojnë me kapital shtetëror, e kanë për detyrë që në Komisionin Shtetëror për Parandalim të Korrupsionit të dërgojné të dhëna për numrin, llojin, targat e regjistrimit dhe gjendjen e mjeteve motorike me të cilat menaxhojnë ku të dhënat dërgohen në formë elektronike në formular të cilin me propozim të Komisionit Shtetëror për Parandalim të Korrupsionit e përcakton Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve kështu që Komisioni Shtetëror për Parandalim të Korrupsionit, në ueb faqen e vet e publikon regjistrin e mjeteve motorike zyrtare të fondeve publike, ndërmarrjeve publike dhe të gjithë personave tjerë juridik që menaxhojnë me kapital shtetëror<sup>8</sup>.

---

<sup>7</sup> Për më tepër shih në: Pika 6 dhe neni 8 i Kodit zgjedhor të RMV-së: Propozimi i tekstit të konsoliduar) në dispozicion në linkun: [https://drive.google.com/file/d/1Sa9L6emhxl2VaV\\_8d7oK3hJ6r1usnuY/view](https://drive.google.com/file/d/1Sa9L6emhxl2VaV_8d7oK3hJ6r1usnuY/view).

<sup>8</sup> Për më tepër shih në: Pika 6 dhe neni 8 i Kodit zgjedhor të RMV-së: Propozimi i tekstit të konsoliduar) në dispozicion në linkun: [https://drive.google.com/file/d/1Sa9L6emhxl2VaV\\_8d7oK3hJ6r1usnuY/view](https://drive.google.com/file/d/1Sa9L6emhxl2VaV_8d7oK3hJ6r1usnuY/view).

### 1.5. Numri i këshilltarëve komunalë në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Sipas Ligjit për vetëqeverisje lokale, këshilli i komunës paraqet organin kolegjal përfaqësues të qytetarëve, të cilin e përbëjnë përfaqësues të qytetarëve të zgjedhur në zgjedhje të përgjithshme, të drejtpërdrejta dhe të lira me votim të fshehtë ku anëtarët e këshillit zgjedhen me mandat katërvjeçar, i përfaqësojnë qytetarët dhe në këshill vendosin sipas bindjeve të tyre dhe anëtari i këshillit nuk mund të revokohet<sup>9</sup>.

Këshilli përbëhet prej 9 deri 33 anëtarëve varësisht nga numri i banorëve në komunë, edhe atë:

**TABELA 1:**  
**Numri i anëtarëve të Këshillit të Komunës sipas numrit të banorëve në Komunë<sup>10</sup>**

<b>Numri i banorëve</b>	<b>Numri i anëtarëve të Këshillit</b>
<b>deri 5.000</b>	<b>9</b>
<b>prej 5.001 deri 10.000</b>	<b>11</b>
<b>prej 10.001 deri 20.000</b>	<b>15</b>
<b>prej 20.001 deri 40.000</b>	<b>19</b>
<b>prej 40.001 deri 60.000</b>	<b>23</b>
<b>prej 60.001 deri 80.000</b>	<b>27</b>
<b>prej 80.001 deri 100.000</b>	<b>31</b>
<b>mbi 100.000</b>	<b>33</b>

<sup>9</sup> Për më tepër shih në: Ligji për vetëqeverisje lokale, nenet 31-34, "Gazeta zyrtare e RMV-së", nr. 5/2002.

<sup>10</sup> Po aty.

## 1.6. Procedura e kandidimit dhe fushata parazgjedhore në zgjedhjet lokale

Partitë politike të regjistruara, individualisht ose në koalicione, si dhe grupet e votuesve kanë të drejtë të paraqesin listat e kandidatëve për këshilltarë dhe kandidatë për kryetar komune dhe në varësi të madhësisë së njësisë së vetëqeverisjes lokale, grupet e zgjedhësve duhet të mbledhin një numër të caktuar nënshkrimesh, si vijon: nga 100 nënshkrime për njësitë deri në 10.000 banorë, deri në të paktën 450 për njësitë mbi 100.001 banorë, ndërsa për kandidaturën në qytetin e Shkupit nevojiten 1000 nënshkrime ndërsa, në listën e kandidatëve për këshilltarë, në çdo vend të tretë duhet të propozohet një kandidat që i përket gjinisë që është më pak e përfaqësuar në listë dhe lista e kandidatëve për anëtarë të këshillit dhe kandidat për kryetar komune i dorëzohet Komisionit Komunal të Zgjedhjeve në formularin e përcaktuar jo më vonë se 35 ditë para ditës së zgjedhjeve dhe ky komision i shpall këto lista jo më vonë se 25 ditë para ditës së zgjedhjeve, kështu që, nominimi i kandidatëve bëhet me dorëzim të listës së kandidatëve në Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve, pra, një kandidat mund të nominohet vetëm në një listë, dhe një parashtrues i listës mund të paraqesë vetëm një listë të kandidatëve për kryetar komune ose kandidatë për anëtarë të këshillit<sup>11</sup>.

Nga ana tjetër, për sa i përket fushatës parazgjedhore në zgjedhjet e shtata lokale të v. 2021, duhet theksuar se, fushata parazgjedhore filloi 20 ditë para ditës së zgjedhjeve, pra më 27 shtator në orën 00:00h dhe përfundoi më 15 tetor në orën 24:45h ndërkaq, fushata parazgjedhore për raundin e dytë të votimit zgjati deri në orën 24:00h të datës 29 tetor 2021 ku në raundin e parë dhe të dytë të votimit, fushata parazgjedhore nuk duhet të zgjasë 24 orë para ditës së zgjedhjeve dhe ditës së zgjedhjeve dhe një ditë para raundit të parë të zgjedhjeve, gjegjësisht 16 tetori ishte ditë e heshtjes parazgjedhore kur kandidatët nuk lejoheshin të bënin fushatë parazgjedhore dhe mediat nuk lejoheshin të prezantojnë pjesëmarrësit e zgjedhjeve në procesin zgjedhor dhe, e njëjta gjë vlejti edhe për 30 tetorin, pra një ditë para raundit të dytë të zgjedhjeve<sup>12</sup>.

<sup>11</sup> Për më tepër shih në: Марко Панковски; Никола Михајловски; Ива Наскова; Здравко Ставров, Прирачник за локални избори во Република Северна Македонија 2021 година, Второ дополнето издание, декември 2021, КАС, Скопје, стр. 42-43.

<sup>12</sup> По ату, fq. 44.

## 1.7. Mbikëqyrja e zgjedhjeve lokale

Vëzhguesit e akredituar kanë të drejtë të vëzhgojnë zgjedhjet, ndërsa autorizimin e lëshon KSHZ-ja, ku akreditimin për vëzhgues mund ta marrin organizatat e shoqërisë civile vendase dhe të huaja, të cilat janë regjistruar të paktën një vit para zgjedhjeve dhe në statutin e tyre kanë të inkorporuar parimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, mirëpo duhet thënë se zgjedhjet mund t'i vëzhgojnë edhe përfaqësues të vendeve të huaja dhe përfaqësuesit e autorizuar të parashtruesve të listave kanë të drejtë të caktojnë përfaqësuesin e tyre i cili do të monitorojë punën e organeve zgjedhore<sup>13</sup>.

---

<sup>13</sup> Për më tepër shih në: Прирачник за претседателски избори во Република Северна Македонија 2019 година, второ дополнето издание, 2019, fq. 15.

## KAPITULLI I DYTË

### HISTORIKU I ZGJEDHJEVE LOKALE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

#### 2.1. Zgjedhjet e para lokale të v. 1996

Zgjedhjet e para lokale në Republikën e pavarur të Maqedonisë u mbajtën në vitin 1996, me dalje mesatare të votuesve për zgjedhjen e këshilltarëve për komunat 60,17%, ndërsa për qytetin e Shkupit 53,20%, ku dalja mesatare e votuesve për kryetar komune ishte 60,28%, ndërsa për qytetin e Shkupit 53,20%, ku duhet potencuar faktin që gjatë këtyre zgjedhjeve votimi është anuluar në komuna të caktuara, kështu që në këto të dhëna nuk përfshihen rezultatet e zgjedhjes së kryetarëve të komunave apo anëtarëve të këshillit në gjithsej 9 komuna dhe këto zgjedhje lokale u mbajtën sipas organizimit territorial të vitit 1996, sipas të cilit janë formuar 123 komuna dhe Qyteti i Shkupit si njësi e veçantë e vetëqeverisjes lokale, ku LSDM-ja fitoi numrin më të madh të vendeve për kryetar komune: 51, VMRO-DPMNE dhe MAAK-konservatore: 27, dhe Partia Socialiste: 19<sup>14</sup>.

Që nga periudha e shpalljes së pavarësisë së IRJM qarqet nacionaliste maqedonase ndërtuan sistem të atillë të centralizuar, i cili praktikisht i ç'pushtetizonte shqiptarët. Me këtë sistem shqiptarët edhe në komunat ku ishin shumicë nuk ishin faktorë vendimmarrës për shumë çështje jetësore, si në planin ekonomik, arsimor, kulturor, shëndetësor apo të sigurisë. Ligji për vetëqeverisjen lokale, që u miratua në vitin 1995 nuk ishte i përshtatshëm, sepse pushtetin lokal e vendoste në varësi të plotë nga pushteti qendror.

Në zgjedhjet lokale të vitit 1996, përveç partive maqedonase morën pjesë edhe tre parti politike shqiptare: Partia për Prosperitet Demokratik, Partia për Prosperitet Demokratik e Shqiptarëve dhe Partia Demokratike Popullore, ku lufta kryesore politike në këto zgjedhje u zhvillua kryesisht në mes dy krahëve të ish-PPD, Partisë për Prosperitet Demokratik (rryma e vjetër) dhe Partisë për Prosperitet Demokratik të Shqiptarëve (rryma e re)<sup>15</sup>.

<sup>14</sup> Për më tepër për këto zgjedhje të para lokale të v. 1996 shih në: Државна изборна комисија. Локални избори 1996: Конечни резултати од локалните избори за градоначалници и членови на советите на општините и Градот Скопје. Скопје 1997 година; dhe: Јане Димески; Марко Панковски, Прирачник за локални избори во Република Македонија 2017 година, КАС-Скопје, 2017, стр. 25.

<sup>15</sup> Partia politike e quajtur "rryma e re" u regjistrua me emrin: Partia për Prosperitet Demokratik e Shqiptarëve – "PPDSH", me Vendimin e sjellur më datë 18. 04. 1995, Slluzhben vesnik na Republika Makedonija, br. 41/94.



Zgjedhjet lokale ishin një sfidë e madhe për popullin shqiptar të Maqedonisë i cili duhej të zgjidhte midis dy opsioneve të mundshme: politikës tradicionale të partisë shqiptare në pushtet, Partisë për Prosperitet Demokratik, ose opsionit reformator të opozitës shqiptare, Partisë për Prosperitet Demokratik të Shqiptarëve, që përpiquej të imponojë interesin kombëtar të shqiptarëve në RM, ku edhe pse procesi i votimit u manipulua një kohë të gjatë, sidomos në qytetin e Tetovës, rezultati përfundimtar i zgjedhjeve lokale të vitit 1996 tregoi se populli shqiptar në shumicë dërmuese përkrahu kursin reformator të opozitës shqiptare në RM, me çrast ky kurs reformator (PPDSH), korri fitore në dy qendrat kryesore urbane me shumicë shqiptare, në Tetovë dhe Gostivar, si dhe mori shumicën e Këshillave komunale në nivel të RM, pra, ndër shqiptarët e RM, përmes zgjedhjeve lokale të vitit 1996, u legjitimua një politikë, e cila nga njëra anë e kontestonte politikën e degjeneruar dhe apatike shqiptare dhe njëkohësisht kontestonte proceset shoqërore politike që zhvilloheshin në dëm të interesave kombëtarë të shqiptarëve dhe me t'u vendosur në krye të pushtetit lokal, faktori i ri politik filloi të vë në jetë platformën e tij gjenerale, duke u përpjekur të përmirësojë pozitën e shqiptarëve në sistem, atë që ia mundësonte Ligji për pushtet lokal<sup>16</sup>.

Në krye të Ndërmarrjeve Publike që ishin në kompetencë të komunave, për herë të parë u vendosën udhëheqës shqiptarë. Deri në këtë kohë, rolin udhëheqës në ato ndërmarrje e kishin pasur vetëm maqedonas. Hapi tjetër i rëndësishëm ishte përmirësimi i strukturës nacionale të të punësuarve nëpër ato ndërmarrje, që gjithmonë kishte qenë në dëm të shqiptarëve. Çështje mjaft me rëndësi ishte përmirësimi i infrastrukturës komunale, e cila vite me radhë ishte lënë pas dore dhe gjithashtu, duke shfrytëzuar të drejtën kushtetuese të nenit 48 të Kushtetutës<sup>17</sup>, në të cilën ngërthehen të drejtat e kombeve që jetojnë në RM për të shprehur veçoritë e tyre etnike, Kuvendi komunal i Tetovës dhe Gostivarit dhe Kuvendet e komunave tjera, ku shqiptarët përbënin shumicën, sollën vendim për përdorimin e flamurit kombëtar, i cili u vendos përpara objekteve komunale, krahas simboleve shtetërore të RM<sup>18</sup>.

---

<sup>16</sup> Për më tepër në: Zeqirja Rexhepi, *Zgjedhjet lokale në RM-1996*, në dispozicion në linkun: <http://z-rexhepi.blogspot.com/2008/01/zgjedhjet-lokale-n-i-r-j-m-1996.html>.

<sup>17</sup> Vendimi nr. 08-367/4, të datës 2.7.1996, për emërimin e drejtorit të Ndërmarrjes Komunale, Fondit për Udhë Lokale të Komunës së Tetovës dhe NP. "Geozhineri", i datës 17. 05. 1997, "Fletorja zyrtare e Komunës së Tetovës", nr. 5/96.

<sup>18</sup> Për më tepër në: Zeqirja Rexhepi, *Zgjedhjet lokale në RM-1996*, në dispozicion në linkun: <http://z-rexhepi.blogspot.com/2008/01/zgjedhjet-lokale-n-i-r-j-m-1996.html>.

Mirëpo, Gjykata kushtetuese vendosi ndalimin e përkohshëm të të gjitha simboleve kombëtare shqiptare, me arsyetim se komunat nuk janë kompetente për këtë ku Gjykata kushtetuese obligimin e mëtutjeshëm për zbatimin e vendimit ia la Qeverisë dhe, e tërë kjo gjë, për një kohë të caktuar, mbeti çështje e hapur, mirëpo, Qeveria e priti momentin e përshtatshëm për të intervenuar, me çka u shkaktuan përleshje të mëdha në Gostivar dhe Tetovë në mes popullatës shqiptare dhe forcave policore maqedonase dhe në momentin kur ndodhën këto procese ndodhi edhe një ngjarje me rëndësi të madhe politike, bashkimi i një pjese të faktorit politik shqiptar, të të dy partive politike opozitare, Partisë për Prosperitet Demokratik të Shqiptarëve dhe Partisë Demokratike Popullore<sup>19</sup>.

## **2.2. Zgjedhjet e dyta lokale të v. 2000**

Zgjedhjet e dyta lokale të vitit 2000 kishin një numër të konsiderueshëm shkeljesh të procesit zgjedhor dhe standardeve ndërkombëtare për zgjedhje të lira dhe demokratike. Zgjedhjet kishin një sërë incidentesh, dhunë dhe frikësim të votuesve. Në disa komuna: Gostivar, Tetovë, Labunishtë, Xhepçishtë dhe Mavrovi Anovi, zgjedhjet u pasuan me incidente të armatosura. Në disa qendra votimi në komuna të tjera, kutitë e votimit janë hapur dhe shkatërruar me forcë. Në raundin e dytë të votimit u përsërit dhuna në vende të ndryshme. OSBE/ODIHR<sup>20</sup> regjistroi votimin në grup në 25% të qendrave të votimit të vëzhguara, votim të hapur në 8% dhe votim në emër të një tjetri në 5%, dhe pas këtyre zgjedhjeve, KSHZ nuk i publikoi rezultatet e plota dhe gjithëpërfshirëse të zgjedhjeve. Në raundin e parë, koalicioni “Për Maqedoninë së bashku”, i udhëhequr nga LSDM, fitoi 38% të votave për kryetarë komunash, ndërsa koalicioni VMRO-DPMNE dhe Alternativa Demokratike fituan 27%, PDSH 13% dhe PDP 6%. Rezultatet përfundimtare treguan fitore për koalicionin e VMRO-DPMNE-së dhe Alternativës Demokratike, “Për Ndryshim”, në 48% të komunave, gjegjësisht fituan 59

---

<sup>19</sup> Kushtetuta e RM, Neni 48, thuhet: “Pjestarët e nacionaliteteve kanë të drejtë lirisht të shprehin, kultivojnë dhe zhvillojnë idenitetin dhe veçoritë nacionale. Republika ua garanton mbrojtjen e identitetit nacional, kulturor, gjuhësor dhe fetar...”, Slluzhben vesnik na Republika Makedonija br. 52, 22 noemvri, 1991.

<sup>20</sup> OSCE/OIDHR Office for Democratic Institutions and Human Rights. Former Yugoslav Republic of Macedonia Municipal Elections 10 September 2000. OSCE/OIDHR Election Observation Mission Final Report. Warsaw, 2000.

pozita të kryetarëve të komunave, ndërsa koalicioni i udhëhequr nga LSDM “Për Maqedoninë së bashku” fiton 32 pozita të kryetarëve të komunave<sup>21</sup>.

### 2.3. Zgjedhjet e treta lokale të v. 2005

Zgjedhjet e treta lokale të 2005 përsëri nuk arritën të përmbushin standardet kryesore ndërkombëtare për universalitetin, barazinë dhe fshehtësinë e votes meqë për dallim nga zgjedhjet e mëparshme, këto zgjedhje nuk u karakterizuan me dhunë, por një sërë parregullsishë janë vërejtur në pjesën perëndimore, veriperëndimore të vendit dhe në Shkup dhe në të njëjtën kohë, zgjedhjet e vitit 2005 janë të parat që janë mbajtur nën organizimin territorial të vitit 2004, i cili themeloi 84 komuna në territorin e Maqedonisë dhe e ruajti statusin e qytetit të Shkupit si njësi e veçantë e vetëqeverisjes locale ku vëzhguar nga OSBE/ODIHR<sup>22</sup>, u konstatuan 30 raste të mbushjes së kutive të votimit dhe mbi 50 raste votimi në emër të një tjetri ndërkaq, në 9 komuna, përfshirë edhe qytetin e Shkupit, si rezultat i ankesave për parregullsi në rrethin e parë të votimit, është dashur të përsëritet dhe një raund i dytë votimi ishte planifikuar gjithashtu të zhvillohej në këto qendra votimi, duke rezultuar në një raund të dytë, i cili u zhvillua më 10 prill 2005 ku pjesëmarrja e votuesve në raundin e parë ishte 56.36%, në raundin e dytë më 27 mars ishte 53.66%, dhe më 10 prill ishte 35.6% ndërkaq, koalicioni i udhëhequr nga LSDM fitoi 36 vende për kryetar komune. VMRO-DPMNE dhe koalicioni fituan 21 ulëse për kryetar komune, BDI: 15, VMRO-NP: 3, PDSH: 2 dhe Unioni i Romëve: 1 dhe kryetarë komunash u bënë 7 kandidatë të pavarur, përfshirë edhe kandidatin për Shkupin, Trifun Kostovski, i cili u mbështet nga VMRO-DPMNE<sup>23</sup>.

---

<sup>21</sup> Për më tepër për këto zgjedhje të dyta lokale të v. 2000 shih në: Државна изборна комисија. Локални избори 2000: Конечни резултати од локалните избори за градоначалници и членови на советите на општините и Градот Скопје. Скопје 2000 година; dhe: Јане Димески; Марко Панковски, Прирачник за локални избори во Република Македонија 2017 година, КАС-Скопје, 2017, стр. 26.

<sup>22</sup> ОБСЕ/ОДИХР Канцеларија за демократски институции и човекови права, Поранешна југословенска Република Македонија, Локални избори 12 и 27 март и 10 април 2005. Конечен извештај на Мисијата за набљудување за избори на ОБСЕ/ОДИХР. Варшава, 2005.

<sup>23</sup> Për më tepër për zgjedhjet e treta lokale të v. 2005 shih në: Јане Димески; Марко Панковски, Прирачник за локални избори во Република Македонија 2017 година, КАС-Скопје, 2017, стр. 26-27.

Në këto zgjedhje lokale, për herë të parë në nivel lokal si lojtar politik u paraqit edhe BDI, partia e Ali Ahmetit e cila fitoi kryetarë komunash në: Gostivar, Dibër, Strugë, Tetovë, Haraçinë, Bërvenicë, Vrapçishtë, Zajaz, Bogovinjë, Likovë, Oslomej, Tearcë dhe Çair<sup>24</sup>.

#### **2.4. Zgjedhjet e katërta lokale të v. 2009**

Zgjedhjet e katërta lokale të vitit 2009, të mbajtura në të njëjtën ditë me zgjedhjet presidenciale, janë zgjedhjet e para lokale që mbahen në përgjithësi në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe të OSBE-së për zgjedhje demokratike, mirëpo, megjithatë edhe për këto zgjedhje, OSBE/ODIHR kishte vërejtje të forta për frikësimin e votuesve ku raporti i monitorimit i OSBE/ODIHR vë në dukje frikësimin dhe presionin ndaj votuesve, veçanërisht punonjësve të administratës publike dhe përfituesve të ndihmës sociale, të cilët janë kërcënuar se do të votojnë për partinë në pushtet ku sipas këtij misioni ndërkombëtar u konstatuan: votimi familjar, votimi në emër të një tjetri, i njëjti person duke "ndihmuar" më shumë se një votues, përpjekjet për të ndikuar tek votuesit, frikësimi i votuesve dhe anëtarëve të këshillave zgjedhore, nënshkrimet identike në ekstraktet nga Lista e Zgjedhësve dhe votimi i shumëfishtë dhe ai familjar<sup>25</sup>.

VMRO-DPMNE ishte fituese në 56 komuna, BDI në 15, LSDM në 7 dhe PDSH, ND, DPTM, SR, PDMSM fituan nga një kryetar komune. Dy kandidatë të pavarur fituan gjithashtu vende për kryetar komune<sup>26</sup>.

Raporti i ODIHR/OSBE bëri pesë rekomandime të tjera prioritare:

- për të ndarë shtetin nga partia;
- të korrigjohen të gjitha mangësitë dhe paqartësitë në Kodin Zgjedhor;
- rishikimi dhe korrigjimi i Listës zgjedhore;

<sup>24</sup> Për më tepër në: <https://portalb.mk/443272-analize-dosje-te-gjitha-zgjedhjet-lokale-ne-maqedoni/>.

<sup>25</sup> ОБСЕ/ОДИХР Канцеларија за демократски институции и човекови права, Поранешна југословенска Република Македонија, Локални избори 22 март и 5 април 2009. Конечен извештај на Мисијата за набљудување за избори на ОБСЕ/ОДИХР. Варшава, 2009.

<sup>26</sup> Për më tepër për zgjedhjet e katërta lokale të v. 2009 shih në: Јане Димески; Марко Панковски, Прирачник за локални избори во Република Македонија 2017 година, КАС-Скопје, 2017, стр. 27-28.

-të marrë masa për zgjidhjen e konflikteve të interesit ndërmjet personave të përfshirë në politikë, të cilët ushtrojnë kontroll mbi transmetuesit privatë dhe

-vendosja e afateve brenda të cilave Gjykata do të vendoste për kundërshtimet e Këshillit të Radiodifuzionit<sup>27</sup>.

Në të dy raportet, OSBE/ODIHR bëri thirrje për një rishikim të Listës zgjedhore, e cila është një nga rekomandimet që u zbatua. Bashkimi Evropian konsideron se Republika e Maqedonisë ka bërë përparim në mbajtjen e zgjedhjeve dhe rithekson konkluzionet dhe rekomandimet e OSBE/ODIHR. Ambasadori i atëhershëm i SHBA-ve, Philip Reeker, i vlerësoi zgjedhjet si të mira<sup>28</sup>.

## **2.5. Zgjedhjet e pesta lokale të v. 2013**

Zgjedhjet e pesta lokale të vitit 2013 u zhvilluan në një atmosferë paqësore, duke marrë vlerësime pozitive për efikasitetin e zbatimit të tyre, ndonëse u evidentuan disa mangësi në drejtim të kushteve të pamjaftueshme për të siguruar një fushë të barabartë konkurrimi ndërmjet kandidatëve dhe në këtë kontekst, janë vërejtur dobësi në pjesën e mbivendosjes së aktiviteteve shtetërore dhe partiake, financimin e fushatave zgjedhore, kornizën ligjore, si dhe raportimin mediatik<sup>29</sup>. Megjithatë, në raste të rralla, vërejtjet përfshinin gjithashtu shkelje të fshehtësisë së votimit, votimin familjar dhe shkatërrimin e materialit zgjedhor. Në media u bënë vërejtje serioze kryesisht në drejtim të ndarjes së tyre në vija etnike dhe partiake.

Me këto zgjedhje hyri në fuqi organizimi i ri territorial, i cili për herë të parë zgjodhi kryetarë dhe këshilltarë në 81 komuna, sepse komunës së Kërçovës iu aneksuan komunat Vraneshticë, Drugovë, Zajas dhe Oslomej, ku pjesëmarrja në këto zgjedhje ishte mjaft e lartë meqë në raundin e parë ishte 67%, ndërsa në raundin e dytë që u mbajt në 29 komuna

---

<sup>27</sup> OSBE/ODIHR Kançelarija za demokratски институции и човекови права, Поранешна југословенска Република Македонија, Локални избори 22 март и 5 април 2009. Конечен извештај на Мисијата за набљудување за избори на ОБСЕ/ОДИХР. Варшава, 2009.

<sup>28</sup> Јане Димески; Марко Панковски, Прирачник за локални избори во Република Македонија 2017 година, КАС-Скопје, 2017, стр. 28.

<sup>29</sup> OSBE/ODIHR Kançelarija za demokratски институции и човекови права, Поранешна југословенска Република Македонија Локални избори 24 март и 7 април 2013. Набљудувачка мисија за избори на ОБСЕ Конечен извештај. Варшава, 2013.

pjesëmarrja ishte 59% dhe votim të përsëritur ka pasur në komunën e Dollnenit, ndërsa për shkak të rezultateve të anuluar ka pasur rivotim të rrethit të dytë në katër komuna: Qendër, Dollneni, Strugë dhe Gjorçe Petrov dhe pjesëmarrja në ditën e tretë të zgjedhjeve ishte 65%, ku partia politike më dominuese në këto zgjedhje lokale ishte VMRO-DPMNE, e cila fitoi më së shumti kryetarë komunash në krahasim me partitë tjera meqë VMRO-DPMNE fitoi 56 ulëse për kryetar komune, BDI fitoi 14 kryetarë komunash, LSDM fitoi 4, PDSH fitoi 2, Partia Demokratike e Turqve, Partia Progresive Serbe në Maqedoni dhe Bashkimi i Romëve të Maqedonisë fituan nga një kryetar komune si dhe u zgjodhën edhe dy kandidatë të pavarur për kryetarë komunash<sup>30</sup>.

## 2.6 Zgjedhjet e gjashta lokale të v. 2017

Më 15 tetor 2017 u mbajtën zgjedhjet e gjashta lokale që nga shpallja e pavarësisë së Republikës së Maqedonisë të cilat u zhvilluan në 80 komuna dhe në qytetin e Shkupit, ku kryetarët e komunave dhe qytetit të Shkupit u votuan sipas sistemit zgjedhor të shumicës, ndërsa anëtarët e këshillave u zgjodhën sipas modelit zgjedhor proporcional ndërkaq, të sëmuret, të pafuqishmit, personat në arrest shtëpiak dhe të burgosurit votuan një ditë para dy raundeve, pra më 14 dhe 28 tetor 2017, me çrassit gjithsej 1.079876 nga gjithsej 1.814644 votues të regjistruar në listën e zgjedhësve dolën në votime, duke e çuar pjesëmarrjen në raundin e parë në 59.51%, ndërkaq, në raundin e dytë të zgjedhjeve pjesëmarrja u ul në 51.92%<sup>31</sup>.

Sipas dinamikës së mëparshme, zgjedhjet lokale në Republikën e Maqedonisë mbaheshin çdo katër vjet në gjysmën e dytë të marsit. Megjithatë, për shkak të trazirave dhe krizës politike gjatë vitit 2016 dhe 2017, zgjedhjet lokale të vitit 2017 u shtynë dhe u mbajtën në tetor; dhe këto zgjedhje lokale e ndryshuan në mënyrë drastike raportin e vendeve për kryetar

---

<sup>30</sup> Për më tepër për zgjedhjet e pesta lokale të v. 2013 shih në: МОС Т. Финален извештај, Домашно набљудување на локалните избори 2013. Скопје, 2013; dhe : Јане Димески; Марко Панковски, Прирачник за локални избори во Република Македонија 2017 година, КАС-Скопје, 2017, стр. 28-30.

<sup>31</sup> Излезност на локални избори 2017, Државна изборна комисија. Излезност од прв круг: <https://rezultati2017.sec.mk/Local/Results?cs=mk-MK&r=r&rd=r1> Излезност од втор круг: <https://rezultati.sec.mk/Local/Results?cs=mk-MK&r=r&rd=r1>.

komune mes dy partive më të mëdha politike, VMRO-DPMNE dhe LSDM meqë koalicioni i udhëhequr nga LSDM fitoi 57 vende për kryetar komune, që është 53 më shumë se zgjedhjet e mëparshme të v. 2013, ndërsa, koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE fitoi 5 ulëse për kryetar komune, përkatësisht 51 më pak se në zgjedhjet e kaluara të v. 2013 kurse BDI fitoi 10 vende për kryetar komune, që është 4 më pak se në zgjedhjet e kaluara të v. 2013, ndërkaq, partia politike Aleanca e Shqiptarëve, e cila si subjekt i veçantë politik mori pjesë për herë të parë në këto zgjedhje lokale, fitoi 3 ulëse për kryetar komune, ndërkaq, nga një kryetar komune fituan: BESA, PDSH dhe DPT, ndërsa 3 vende për kryetar komune u takuan kandidatëve të pavarur<sup>32</sup>.

---

<sup>32</sup> Резултати на локални избори 2017, Државна изборна комисија. Резултати од прв круг: <https://rezultati2017.sec.mk/Local/Results?cs=mk-MK&r=r&rd=r1>. Резултати од втор круг: <https://rezultati.sec.mk/Local/Results?cs=mk-MK&r=r&rd=r1>.  
Për më tepër për zgjedhjet e gjashta lokale të v. 2017 shih në: Јане Димески; Марко Панковски, Прирачник за локални избори во Република Македонија 2017 година, КАС-Скопје, 2017, стр. 137-139.

## KAPITULLI I TRETË

### ANALIZA LIGJORE DHE PRAKTIKE E ZGJEDHJEVE LOKALE TË TETORIT 2021 NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT DHE REZULTATET E TYRE

#### 3.1. Përgatitja e zgjedhjeve lokale të tetorit 2021

Procesi i zhvillimit të zgjedhjeve lokale të v. 2021 nisi me përcaktimin e datës së zgjedhjeve, e cila sipas Kodit Zgjedhor është parashikuar të zhvillohet në javën e dytë të tetorit, duke qenë se fushata parazgjedhore do të përkonte pjesërisht me regjistrimin e popullsisë në shtator të v. 2021.

Dilema ishte nëse një përputhje ndërmjet fushatës parazgjedhore dhe regjistrimit të popullsisë mund të pengonte zhvillimin e regjistrimit. Megjithatë, partitë politike vendosën që zgjedhjet lokale të mbahen sipas afatit të përcaktuar me ligj, pra në gjysmën e dytë të tetorit.

Në këtë drejtim, në mars 2021 nisën negociatat për ndryshimin e Kodit Zgjedhor. Negociatat janë zhvilluar ndërmjet përfaqësuesve të Ministrisë së Drejtësisë dhe përfaqësuesve të LSDM-së, VMRO-DPMNE-së, BDI-së dhe Aleancës për Shqiptarët dhe Alternativës. Pas disa muaj negociatash, u ra dakord për disa risi në Kodin Zgjedhor. Një nga risitë dhe ndryshimet kryesore ishte votimi me pajisje speciale për kontrollin e gjurmëve të gishtave të votuesve (fingerprinti). Kjo pajisje do të përcaktojë nëse votuesi ka votuar më parë apo ka gabuar në qendrën e votimit. Iniciativa për këtë zgjidhje fillimisht ka ardhur nga VMRO-DPMNE me qëllim të rritjes së besimit në procesin zgjedhor dhe zvogëlimit të mundësisë për keqpërdorime.

Më vonë, në prag të zgjedhjeve, u diskutua edhe për propozimin e partive parlamentare LSDM, VMRO-DPMNE, BDI dhe Aleancës për Shqiptarët dhe Alternativës për të rritur pragu deri në 2% për kandidatura për kryetar komune ose për listën e këshilltarëve të paraqitura, pra të rritet pragu prej 2% të numrit të përgjithshëm të votuesve në komunë. Në disa zona, kjo do të nënkuptonte një rritje të konsiderueshme të numrit të nënshkrimeve që do të mblidhen, për shembull: nëse për dorëzimin e listës për Qytetin e Shkupit kërkoheshin 1000 nënshkrime deri më tani, me ndryshimet e reja të dakorduara, parashtruesit do të duhej të mblidhnin 9000 nënshkrime. Propozuesit e arsyetuan këtë propozim si një obligim që lidhet me rekomandimet



e OSBE/ODIHR, mirëpo, ndryshimet e propozuara ngjallën debat të gjerë publik dhe reagime nga partitë më të vogla politike, kandidatët e pavarur dhe sektori i shoqërisë civile ku reagimet ishin se një zgjidhje e tillë është një përfitim ekskluziv për partitë më të mëdha dhe se mund të komplikojë ndjeshëm nismat e disa shoqatave dhe individëve për lista të pavarura, kështu që pas këtyre iniciativave të listave të pavarura u vu edhe Kryetari i Republikës Dr. Stevo Pendarovski i cili theksoi se, do të përdorë veton ndaj ndryshimeve të Kodit Zgjedhor nëse ato votohen në Kuvend meqë sipas Pendarovskit, është e palogjikshme që për kandidaturën për Kryetar të Republikës të nevojiten 10.000 nënshkrime, ndërsa një numër identik i nënshkrimeve të nevojiten për zgjedhjet lokale<sup>33</sup>. Pas një sërë kritikash, kryeministri dhe kryetari i LSDM-së, Zoran Zaev, paralajmëroi se propozimi i dakorduar do të tërhiqet<sup>34</sup>.

Karakteristikë e këtyre zgjedhjeve lokale ishte edhe numri i kandidaturave të pavarura për kryetarë dhe këshilltarë komunalë ku me nismën e një grupi qytetarësh u dorëzuan 27-të kandidatura për kryetar komune dhe 65 lista për këshilltarë dhe në 18 komuna kishte të paktën një kandidat të pavarur për kryetar komune ndërsa, tre kandidatë të pavarur për kryetar komune ishin në komunat e Kamenicës, dhe Çuçer Sandevës dhe dy kandidatë të pavarur në komunën e Ilindenit, kështu që pas vendimit për shpalljen e zgjedhjeve lokale 2021 të nënshkruar nga kryetari i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Talat Xhaferi, Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ) miratoi Orarin për zhvillimin e aktiviteteve zgjedhore për zhvillimin e zgjedhjeve lokale dhe në përputhje me këtë orar, KSHZ-ja është e obliguar që pas skadimit të mandatit të komisionit të mëparshëm t'i themelojë Komisionet Komunale të Zgjedhjeve dhe më pas, pas formimit, KKZ-ja formon këshillat zgjedhore dhe plotëson anëtarët dhe zëvendës anëtarët të cilëve u është ndërprerë mandati për arsye të ndryshme, ndërsa KKZ-të i parashtrojnë kërkesë partive politike opozitare që kanë fituar më shumë vota në zgjedhjet e fundit dhe partive politike në pushtet që kanë fituar më shumë vota në zgjedhjet e fundit, që të

---

<sup>33</sup> „Претседателот Пендаровски нема да ги потпише измените на Изборниот законик“, Voice of America, 30 јули 2021.

<sup>34</sup> „Пратениците на одмор, локалните избори распишани, изборниот законик на пауза“, Радио Слободна Европа, 6 август 2021.

paraqesin propozime për anëtarët e KKZ-ve dhe zëvendësit e tyre dhe të dorëzojnë propozimet më së voni deri më 1 shtator<sup>35</sup>.

### **3.2. Ndryshimet e fundit ligjore përkitazi me zgjedhjet lokale të tetorit 2021**

Në periudhën nga zgjedhjet e fundit lokale të vitit 2017 deri në zgjedhjet e planifikuara për 17 tetor 2021, janë miratuar disa ligje të reja dhe ndryshime në legjislacionin ekzistues, duke u kryer disa ndryshime lidhur me dispozitat e Kodit Zgjedhor të cilët kanë të bëjnë me organet zgjedhore shtetërore, financimin e fushatës politike, pjesëmarrësit në fushatë, si dhe dispozitat ligjore të Ligjit për shërbimet mediatike audiovizive dhe miratimin e ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit, kështu që, në v. 2021 Kodi zgjedhir u ndryshua dy herë, në prill dhe shtator 2021ku me këto ndryshime u rregullua mënyra e votimit me dhe pa pajisje teknike dhe u rregullua mënyra e përcaktimit të identitetit të votuesit në procedurën e votimit me gjurmë gishtash mirëpo, gjithashtu, janë ndryshuar edhe afatet lidhur me procedurën për mbrojtjen e të drejtës së votës dhe është përcaktuar mënyra e votimit në rast pandemie dhe në vijë me këtë, nga këto zgjedhje, parashtruesit e listës ose kandidaturës mund ta tërheqin atë brenda 48 orëve nga vendimi për listat përfundimtare (neni 67 paragrafi 12 i Kodit Zgjedhor), i cili merret jo më vonë se data 18 shtator ndërkaq, kur flitet për tërheqjen e listës së kandidatëve, ajo mund të tërhiqet vetëm në tërësi<sup>36</sup>.

Ndryshimet në Kodin Zgjedhor të vitit 2021 poashtu e plotësuan edhe përmbajtjen e Listës Zgjedhore me shenja gishtash dhe një barkod të veçantë për identifikimin me gjurmë gishtash, me çrast htetasit, të cilëve me vendim gjyqësor të formës së prerë u është hequr plotësisht zotësia e veprimit ose me vendim gjyqësor të formës së prerë u hiqet pjesërisht, nuk do të regjistrohen në Listën zgjedhore, ku gjykata ka konstatuar se personi nuk ka zotësi për të shprehur vullnetin individual dhe gjithashtu me ndryshimet e fundit në Kodin Zgjedhor, personat që ndodhen në paraburgim ose në vuajtje të dënimit me burg kanë mundësinë të

---

<sup>35</sup> Për më tepër shih në: Марко Панковски; Никола Михајловски; Ива Наскова; Здравко Ставров, Прирачник за локални избори во Република Северна Македонија 2021 година-Второ дополнето издание, КАС-Скопје, Декември 2021, стр. 7-10.

<sup>36</sup> Për më tepër shih në: Kodi zgjedhor i RMV-së (Propozimi i tekstit të konsoliduar) në dispozicion në linkun: [https://drive.google.com/file/d/1Sa9L6emhxl2VaV\\_8d7oK3hJ6r1usnuY/view](https://drive.google.com/file/d/1Sa9L6emhxl2VaV_8d7oK3hJ6r1usnuY/view).

kontrollojnë të dhënat e tyre gjatë kontrollit publik të Listës Zgjedhore ndërsa KSHZ-ja ka afat prej 3 ditësh pas përfundimit të inspektimit publik që Listën zgjedhore t'ua dorëzojë partive politike që paraprakisht kanë dorëzuar kërkesë elektronike ndërkaq, poashtu, Ministria e Punëve të Brendshme, përveç të dhënave të përcaktuara më parë në nenin 43, duhet të dorëzojë në KSHZ fotografinë dhe gjurmët e gishtërinjve të të gjithë qytetarëve madhorë, pas shpalljes së zgjedhjeve<sup>37</sup>.

Si ndryshime më të rëndësishme dhe si risi që për herë të parë u zbatuan në zgjedhjet në përgjithësi në RMV, ishin ndryshimet që rregulluan mënyrën e përcaktimit të identitetit të votuesit:

Neni 108-a shpjegon në mënyrë të detajuar procedurën e vërtetimit të identitetit sipas së cilës, Këshilli zgjedhor e kontrollon identitetin e votuesve me letërnjoftim të vlefshëm ose pasaportë të vlefshme, përkatësisht letërnjoftim ose pasaportë të cilës i ka skaduar vlefshmëria në periudhën nga shpallja e zgjedhjeve deri në ditën e mbajtjes së tyre dhe me shenjë gishti, ndërkaq, zgjedhësi nuk mund të votojë nëse nuk ka dokument identifikimi dhe nëse shenja e gishtit nuk përputhet me gjurmën e gishtit në Listën elektronike të Zgjedhësve me atë që nëse votuesi tashmë ka votuar, pajisjet teknike raportojnë dhe ai person nuk do të lejohet të votojë dhe nëse pajisja biometrike e identifikimit nuk përputhet me gjurmën e gishtit me gjurmën e gishtit të disponueshëm në Listën elektronike të Zgjedhësve, dhe Këshilli Zgjedhor ka vërtetuar identitetin personal të votuesit nëpërmjet një dokumenti të vlefshëm identifikimi dhe nëse vërtetohet se nuk është regjistruar asnjë votë e mëparshme, zgjedhësi hyn në pajisje duke futur numrin unik të identifikimit<sup>38</sup>. Verifikimi i identitetit të zgjedhësit kryhet pa pajisje teknike në rastet kur zgjedhësi është person i sëmurë ose i pafuqishëm, ose ndodhet në një institucion për përkujdesje jashtëfamiljare ose vuan dënimin me burg<sup>39</sup>.

Nga ana tjetër, Kodit zgjedhor i është shtuar edhe një nen i ri 111-b, i cili trajton procesin zgjedhor në kohë pandemie sipas të cilit, personat në karantinë ose në izolim mund të ushtrojnë të drejtën e votës një ditë para raundit të parë, pra 16 tetor dhe 30 tetor, nëse ka një

---

<sup>37</sup> Për më tepër shih në: Марко Панковски; Никола Михајловски; Ива Наскова; Здравко Ставров, Прирачник за локални избори во Република Северна Македонија 2021 година-Второ дополнето издание, КАС-Скопје, Декември 2021, стр. 8-11.

<sup>38</sup> Државна изборна комисија, Упатство за начинот на утврдување на идентитетот на гласачот, 2021 година.

<sup>39</sup> По ату.

raund të dytë mirëpo, është e nevojshme të njoftohet Komisioni Komunal i Zgjedhjeve, përkatësisht Komisioni Zgjedhor i Qytetit të Shkupit pesë ditë para ditës së caktuar për votim ndërsa, Komisionet Komunale të Zgjedhjeve i mbledhin të dhënat nga Inspektorati Shtetëror Sanitar Shëndetësor, i cili është i detyruar t'i dorëzojë të dhënat 24 orë nga kërkesa e paraqitur kurse, KSHZ-ja themelon borde të posaçme zgjedhore të përbëra nga tre profesionistë shëndetësorë të cilët kryejnë votimin, ku partitë politike mund të caktojnë një anëtar në bordin e posaçëm zgjedhor dhe nga ana tjetër, Ministria e Shëndetësisë siguron pajisjet e nevojshme mbrojtëse për anëtarët e organeve zgjedhore, dhe nëse hapësira e paraparë për votim nuk i plotëson kushtet, atëherë KSHZ-ja mund të caktojë një hapësirë tjetër të përshtatshme që i plotëson kushtet për votim në rast pandemie<sup>40</sup>.

### **3.3. Pjesëmarrësit në zgjedhjet lokale të tetorit 2021**

Në zgjedhjet lokale të v. 2021, individualisht ose në koalicion, u paraqitën 24 subjekte politike si parashtruese të listave të kandidatëve për kryetarë komunash dhe karakteristikë e këtyre zgjedhjeve lokale është mospërputhja e madhe ndërmjet kandidatëve meshkuj dhe femra për arsye se, koalicioni i udhëhequr nga LSDM ka paraqitur më së shumti kandidatura: 69, prej të cilave 5 gra, kurse nga partitë më të mëdha, VMRO-DPMNE me koalicionin e saj ka nominuar 63 kandidatë, prej tyre 3 gra, BDI ka nominuar 19 kandidatë për kryetarë komunash, prej tyre vetëm një grua, Lëvizja Besa ka propozuar 11 kandidatë, asnjë prej të cilëve nuk është grua, ndërsa PDSH-ja ka propozuar 14 kandidatë, një prej të cilëve është grua, ndërkaq, Koalicioni Aleanca për Shqiptarët dhe Alternativa garoi me 15 kandidatë, pa asnjë kandidate grua, ndërsa Koalicioni i vendosur për ndryshim kishte 18 kandidatë, 5 prej të cilëve gra, kure kanë mbetur me tetë prej tyre dy gra, Integra me 10 kandidatë nga të cilët një grua, TMRO me nëntë nga të cilat dy ishin kandidate gra, Partia Politike Demokrate, punëtorë dhe të pavarur, me gjashtë kandidatë pa asnjë kandidate grua, dhe Partia e epokës maqedonase e treta/Lista e pavarur maqedonase me shtatë kandidatë, një prej të cilëve është grua dhe Partia Demokratike

---

<sup>40</sup> Për më tepër shih në: Kodi zgjedhor i RMV-së (Propozimi i tekstit të konsoliduar) në dispozicion në linkun: [https://drive.google.com/file/d/1Sa9L6emhxl2VaV\\_8d7oK3hJ6r1usnuY/view](https://drive.google.com/file/d/1Sa9L6emhxl2VaV_8d7oK3hJ6r1usnuY/view).

e Turqve të Maqedonisë garoi me 5 kandidatë meshkuj, ndërsa Bashkimi Demokratik Boshnjak me katër kandidatë meshkuj kurse Partia Demokratët e Bashkuar të Maqedonisë kishte tre kandidatë meshkuj, ndërsa partia Atdheu Maqedonia kishte dy kandidatë meshkuj dhe një grua dhe “Partia juaj” garoi me dy kandidatë dhe partitë Alternativa, ROM-Romeske, Partia Komuniste e Maqedonisë-forcat e Titos, Lëvizja për Bashkim Kombëtar të Turqve, Lëvizja për Demokraci, të Drejta dhe Liri dhe Opsioni Qytetar për Maqedonia garuan me një kandidat, prej të cilëve të gjithë meshkuj, pra gjithsej 25 kandidatura për kryetar komune janë paraqitur nga një grup zgjedhësish, dy prej të cilëve janë gra me çrast, nga gjithsej 299 kandidatë për kryetar komune, vetëm 25 janë gra (dmth. 8.41% e numrit të përgjithshëm të pjesëmarrësve)<sup>41</sup>.

Mirëpo, ndryshe është situata me kandidatët për këshilltarë ku nga gjithsej 10.635 kandidatë për këshilltarë, 45% janë gra, kryesisht si pasojë e kushtit që çdo i treti kandidat në listat e propozuara të jetë i gjinisë më pak të përfaqësuar<sup>42</sup>.

### **3.3.1. Partitë politike dhe koalicionet**

Në demokraci, secili qytetar mund të marrë pjesë në këtë process- duke pranuar lirisht informacione për çështjet politike, duke shprehur në mënyrë të hapur mendimin e vet mbi çështjet publike, duke formuluar pritjet, propozimet apo kërkesat pa frikën e represionit, duke votuar në zgjedhje, duke u angazhuar në organizata të shoqërisë civile apo parti politike, apo duke qëndruar si kandidatë në zgjedhje demokratike.<sup>43</sup>

Partitë garojnë mes vete për mënyrën më të mirë të zgjidhjes së problemeve politike dhe janë në garë për influencë dhe pushtet sepse pa pushtet për të zbatuar vizionin politik nuk është e mundur të organizohet një shoqëri, me çrast diskutimet e brendshme dhe konfliktet brenda saj, si dhe mes diskutimeve të brendshme dhe konflikteve brenda, si dhe në mes,

---

<sup>41</sup> Për më tepër shih në: Марко Панковски; Никола Михајловски; Ива Наскова; Здравко Ставров, Прирачник за локални избори во Република Северна Македонија 2021 година-Второ дополнето издание, КАС-Скопје, Декември 2021, стр. 12-13.

<sup>42</sup> Për më tepër shih në: Марко Панковски; Никола Михајловски; Ива Наскова; Здравко Ставров, Прирачник за локални избори во Република Северна Македонија 2021 година-Второ дополнето издание, КАС-Скопје, Декември 2021, стр. 12-13.

<sup>43</sup> Wilhem Hofmeister dhe Karsten Grabowm, Partitë politike Funkcioni dhe organizimi në shoqëritë demokratike, Global Consulting & Development Associates LLC Gjilan, Kosovë.

shoqërojnë partitë në këtë garë për ide dhe pushtet dhe ato janë të ligjshme dhe thelbësore sepse brenda çdo shoqërie ekzistojnë opinione, nevoja, pritje dhe pikëpamje të ndryshme për problemet ditore dhe gjithashtu ekzistojnë pyetje të “mëdha” mbi organizimin e shoqërisë, normat dhe procedurat ku nuk ekziston diçka e ngjashme me vullnetin e përbashkët të popullatës apo të mira të përbashkëta të pararcaktuara meqenëse ndryshe, në çdo shoqëri ka interesa rivale të cilat shpesh ndeshen shumë forte njëra me tjetrën në mënyrë që paqësisht të ndërmjetësojnë konfliktin, formimi i pikëpamjeve politike duhet të ndodh në një proces të hapur të debatit mes opinioneve të ndryshme ku është i nevojshëm minimumi i bindjes së përbashkët dhe, ky është mendimi praktik i demokracisë i cili bazohet në parimin se secili qytetarë ka të drejtë të përfaqësojë opinionin dhe bindjen e vet në një garë paqësore të opinioneve dhe ky supozim i konfliktit të interesave brenda çdo shoqërie, që në parim janë legjitime, quhet pluralizëm apo “teori konkurrimi” e demokracisë dhe së këndejmi sipas kësaj teorie, formimi i opinionit politik në një shoqëri pluraliste arrihet nëpërmjet një procesi të hapur të konkurrimit mes interesave heterogjene mirëpo, për shkak të llojlojshmërisë së opinioneve dhe konflikteve sociale nuk ka zgjedhje të përsosur për problemet sepse vendimet duhet të merren në bazë të pëlqimit dhe aprovimit të shumicës së qytetarëve, ku megjithatë, nuk mund të ketë asnjë “tirani e shumicës” që i fyen rregullat demokratike dhe shkel të drejtat e patjetërsueshme të njeriut meqë edhe vendimet e shumicës mund të përfshijnë mangësi apo edhe padrejtësi, prandaj, një mbrojtje e veçantë dhe e garantuar me kushtetutë e pakicave në njërin anë, si dhe pranimi i votimit ose të humbjes në zgjedhje e palës humbëse në anën tjetër, me kusht që ato të jenë kredibile, të lira dhe të ndershme, janë elementet konstituive të këtij koncepti të demokracisë edhe atë brenda kontekstit të konflikteve të interesave të menaxhuara në mënyrë demokratike, partitë politike përfaqësojnë interesat e veçanta dhe vetëm atëherë kur të jenë shprehur hapur interesat e kundërta dhe partitë i akordojnë partive të tjera të drejtën për të përfaqësuar interesat e veçanta, dhe kur palët pajtohen me parimet e lojës politike, për shembull: në qoftë se ata bien dakord kryesisht në kushtetutë demokratike atëherë është e mundur që të zgjidhen konfliktet në një shoqëri dhe të krijohen kompromiset politike në një mënyrë të përshtatshme ku natyrisht, liritë e partive duhet të sigurohen gjatë procesit që do të thotë se krijimi i partive politike duhet të jetë i lirë nga kufizimet politike mirëpo, megjithatë,

mund të ketë disa kufizime për sa i përket krijimit të partive të cilat në mënyrë të hapur e kundërshtojnë kushtetutën demokratike të një shteti, mirëpo, megjithatë, në parim qytetarët duhet të kenë të drejtë të krijojnë një parti politike, e të jenë pjesë e një partie, dhe të shprehin vullnetin e tyre lirshëm në to meqë liria e partive politike gjithashtu e përfshin konceptin se askush nuk mund të shtyhet me forcë të aderojë tek një parti e veçantë politike apo të mbetet në atë parti politike edhe përkundër dëshirës sepse afirmimi dhe artikulimi i shumëllojshmërisë së partive politike është një concept i njohjes së demokracisë pluraliste dhe përfaqësuese<sup>44</sup>.

### **3.3.1.1. VMRO-DPMNE**

VMRO-DPMNE është parti që deklarohet si parti popullore në të djathtë të qendrës, me prejardhje ideologjike kristiano-demokrate e cila që nga pavarësia, është njëra nga dy partitë më të mëdha në RMV, duke kandiduar pothuajse në të gjitha zgjedhjet parlamentare dhe lokale, me përjashtim të zgjedhjeve parlamentare të vitit 1994, kur e bojkotoi raundin e dytë kështu që, prej themelimit deri në vitin 2003, kryetar i VMRO-DPMNE-së ishte Ljubčo Georgievski ndërsa në kongresin e partisë në maj të vitit 2003, Georgievski e dha dorëheqjen dhe në vend të tij u zgjodh Nikolla Gruevski i cili udhëhoqi me këtë parti politike deri në dhjetor të vitit 2017, kur dha dorëheqje nga posti i tij, që u pranua nga Komiteti Qendror, ndërsa në Kongresin e 16-të të jashtëzakonshëm, të mbajtur në dhjetor 2017, kryetar i partisë u zgjodh Hristijan Mickovski me atë që në zgjedhjet parlamentare të vitit 2020, VMRO-DPMNE udhëhoqi koalicionin “Përtëritja e Maqedonisë” dhe fitoi 44 mandate parlamentare<sup>45</sup>.

---

<sup>44</sup> Wilhem Hofmeister dhe Karsten Grabowm, Partitë politike Funkioni dhe organizimi në shoqëritë demokratike, Global Consulting & Development Associates LLC Gjilan, Kosovë.

<sup>45</sup> Për më tepër shih në ueb faqen zyrtare të VMRO-DPMNE-së: <https://www.vmro-dpmne.org.mk/>.

### **3.3.1.2. Bashkimi Demokratik për Integrim**

Bashkimi Demokratik për Integrim doli nga ish-anëtarët e ish-Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare (UÇK), e cila nisi një konflikt të armatosur në v. 2001 dhe ideologjikisht, deklarohet si parti e qendrës së majtë që mbron të drejta më të mëdha të shqiptarëve dhe zbatimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit, me çrast kjo parti politike u formua në vitin 2002 dhe mori pjesë në zgjedhjet parlamentare për herë të parë në të njëjtin vit, duke fituar numrin më të madh të votave në mesin e elektoratit etnik shqiptar, duke siguruar gjithsej 16 mandate parlamentare dhe duke u bërë pjesë e qeverisë së udhëhequr nga LSDM, ndërsa në zgjedhjet parlamentare të vitit 2016, BDI shënoi një rezultat dukshëm më të ulët, duke fituar vetëm 10 deputetë, pjesërisht për shkak të rritjes së Aleancës së Shqiptarëve dhe BESA, mirëpo, në koalicion me LSDM-në, BDI ishte sërish pjesë e Qeverisë<sup>46</sup>.

Ali Ahmeti është kryetar i partisë që nga themelimi i saj me atë që, në nivel lokal në zgjedhjet lokale të vitit 2017, BDI kishte 10 kryetarë komunash nga gjithsej 80 komuna dhe nga qyteti i Shkupit, ndërsa në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të vitit 2020, BDI fitoi 15 mandate, e cila pas negociatave paszgjedhore me LSDM-në përsëri e formoi shumicën parlamentare duke u bërë pjesë e qeverië, ndërkaq, në qershor të vitit 2021, në festën e 19-vjetorit të BDI-së, partia njoftoi se do të vendosë një agjendë të gjelbër dhe do të fokusohet në ruajtjen e mjedisit jetësor kurse në zgjedhjet lokale të vitit 2021, BDI garoi me kandidatë për kryetarë komunash në 19 komuna dhe lista për këshilltarë në 34 komuna, ndërsa në komunën e Çashkës garoi së bashku me Aleancën për Shqiptarët<sup>47</sup>.

### **3.3.1.3. Lidhja Socialdemokrate e Maqedonisë**

Lidhja Socialdemokrate e Maqedonisë deklarohet si parti e qendrës së majtë, me origjinë ideologjike socialdemokrate, e cila u themelua në Kongresin e 21 prillit 1991, si trashëgimtare ligjore e Bashkimit të Komunistëve të Maqedonisë - Partia për Transformim Demokratik (SKMDDP), ndërkaq, në të njëjtin vit partia e ndryshoi emrin e saj në LSDM dhe

---

<sup>46</sup> Për më tepër hih në ueb faqen e BDI-së: <https://bdi.mk/>.

<sup>47</sup> Po aty.



ideologjinë e saj nga komuniste në socialdemokrate duke marrë pjesë në të gjitha zgjedhjet parlamentare dhe lokale që nga pavarësia e RMV-së, me atë që në zgjedhjet e fundit lokale të vitit 2017, LSDM kishte pushtet në 57 nga 80 komuna dhe në qytetin e Shkupit, ndërsa në zgjedhjet e fundit të parakohshme parlamentare të vitit 2020, LSDM dhe partnerët e saj të koalicionit fituan gjithsej 46 ulëse dhe në negociatat paszgjedhore me BDi-në dhe PDSH-në arritën ta formojnë shumicën parlamentare dhe të formojnë qeverinë kurse në zgjedhjet lokale të vitit 2021, LSDM me partitë tjera politike garoi së bashku në koalicion të titulluar: “Më e mira për komunën time”, me kandidatë për kryetarë komunash në 68 komuna dhe një kandidat për kryetar të qytetit të Shkupit dhe 80 lista për këshilltarë komunalë<sup>48</sup>.

#### **3.3.1.4. Aleanca për Shqiptarët**

Aleanca për Shqiptarët është një parti politike që buron nga Lëvizja për Reforma në Partinë Demokratike të Shqiptarëve, që drejtohet nga Zijadin Sela dhe synimi kryesor i Aleancës për Shqiptarët është barazia e plotë mes shqiptarëve dhe maqedonasve në të gjitha fushat, si: investimet, përfaqësimi institucional, akses i drejtë në institucionet shtetërore, punësimi, infrastruktura dhe ngritja e vetëdijes kombëtare, ku në zgjedhjet lokale të vitit 2017, më pas si Aleancë e Koalicionit të Shqiptarëve kandidoi në komunën Gostivar dhe Dibër, ndërsa në zgjedhjet parlamentare të vitit 2020, Aleanca për Shqiptarët dhe koalicioni Alternativa fituan 12 mandate kurse në zgjedhjet lokale të v. 2021 ASH ishte në koalicion me partinë politike Alternativa me gjithsej 15 kandidatë për kryetarë komunash dhe poashtu, në këto zgjedhje lokale ASH-A shpallën edhe koalicion parazgjedhor me VMRO-DPMNE me fokus në Qytetin e Shkupit<sup>49</sup>.

#### **3.3.1.5. Partia Alternativa**

Partia politike Alternativa u formua në vitin 2019 ku Kuvendi Qendror e emëroi për kryetar të parë Afrim Gashin ndërsa më 16 maj 2022 në kongres Gashi u zgjodh në mandatin e

---

<sup>48</sup> Për më tepër shih në ueb faqen e LSDM-së: <https://sdsd.org.mk/>.

<sup>49</sup> Për më tepër shih në ueb faqen e ASH-së: <https://aleanca.mk/>.

dytë<sup>50</sup>. Partia vjen nga anëtarët e Lëvizjes Besa, të cilët vendosën të formojnë një parti të re pas rezultateve të dobëta të zgjedhjeve lokale të 2017-ës, kurse në zgjedhjet parlamentare të vitit 2020, Aleanca për Shqiptarët dhe koalicioni Alternativa fituan 12 mandate me çrast duhet thënë se, programi politik mbështetet në katër shtylla kryesore: Zhvillimi, Integrimi, Dialogu i Hapur dhe Drejtësia, ku në zgjedhjet lokale të v. 2021, kjo parti politike garoi në koalicion me partinë Aleanca për Shqiptarët me gjithsej 15 kandidatë për kryetar komune<sup>51</sup>.

### **3.3.1.6. Lëvizja BESA**

Partia politike Lëvizja BESA është themeluar më 23 mars 2015 në Shkup me kryetar Bilall Kasami dhe synon të promovojë interesat e të gjithë qytetarëve, veçanërisht të shqiptarëve, ku angazhimet bazë kanë të bëjnë me: barazinë, drejtësinë, lirinë dhe prosperitetin, me çrast, Lëvizja Besa nis nga pozicioni asimetrik i shtetit ndaj popujve në të dhe në vend të asimetrisë, shteti duhet të bazohet në: parimet e lirisë, barazisë, drejtësisë, prosperitetit, luftës kundër korrupsionit dhe për arritjen e këtyre synimeve, Lëvizja Besa përpiqet të ndryshojë funksionimin e sistemit në vend, të zhvillojë vlerat universale të humanizmit, të përmirësojë demokracinë në vend, të eliminojë të gjitha format e diskriminimit dhe të ndërtojë shtetin ligjor, ndërsa kjo parti mori pjesë për herë të parë në zgjedhjet parlamentare në vitin 2016, ku fitoi gjithsej 5 deputetë, (4,86% e votave në shkallë vendi) kurse në zgjedhjet e kaluara parlamentare të vitit 2020, Besa ka marrë pjesë në koalicionin “Mundemi” të udhëhequr nga LSDM, i cili ishte koalicioni i parë parazgjedhor ndërmjet partive politike nga blloku maqedonas dhe shqiptarë<sup>52</sup>

### **3.3.1.7. Levica**

Partia Politike Levica u themelua në fund të vitit 2015, e cila sipas statutit, ka një ideologji të fortë majtiste dhe mbron vlerat e majta, duke përfshirë antikapitalizmin, anti-

---

<sup>50</sup> Për më tepër shih në ueb faqen e Alternativës: <https://alternativa.mk/>.

<sup>51</sup> Po aty.

<sup>52</sup> Për më tepër shih në ueb faqen e Lëvizjes Besa: <https://www.levizjabesa.mk/>.

nacionalizmin, anti-militarizmin, anti-klerikalizmin dhe anti-konservatorizmin, me çrast fokusi i partisë është te të drejtat e punëtorëve dhe ato elementare të njeriut dhe si parti ajo qëndron mbi të gjitha për të varfrit, të paprivilegjuarit, të marginalizuarit dhe të shtypurit, kështu që, në zgjedhjet parlamentare të vitit 2016 partia ka garuar e vetme, duke fituar 12.120 vota (1,02%), ndërsa në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të v. 2020, partia doli në vendin e pestë për nga numri i votave të fituara, ku për listat e kandidatëve të kësaj partie votuan 37.426 votues, që përbën 4,1% të numrit të përgjithshëm të votave, duke fituar kështu 2 mandate parlamentare dhe për herë të parë i ka deputetët e saj në Kuvend<sup>53</sup>.

Iniciativa për formimin e Levicës erdhi nga anëtarë të Lëvizjes për Drejtësi Sociale "Lenka", anëtarë të Lëvizjes së majtë "Solidariteti", anëtarë të Partisë Komuniste të Maqedonisë, sindikatave, veprimtarë dhe individë të majtë ku deri në vitin 2019, Partia Levica kishte një kryesi kolektive: Presidiumin, i përbërë nga shtatë anëtarë me mandat imperative ndërkaq, në seancën e rregullt të Plenumit të partisë politike miratohet statuti i ri i partisë, i cili ndryshoi strukturën organizative, ku përveç organeve bazë drejtuese: Plenumi, Komiteti Qendror, Presidiumi dhe Tribunali, prezantohet edhe pozita e kryetarit për një mandat katër vjeçar, ku presidenti aktual i partië politike Levica është Dr. Dimitar Apasiev<sup>54</sup>.

#### **3.4. Fushata parazgjedhore e zgjedhjeve lokale e periudhës nga 27 shtatori deri 15 tetori 2021 dhe financimi i saj**

Fushata parazgjedhore për zgjedhjet lokale filloi më 27 shtator dhe përfundoi në mesnatën e 15 tetorit, me çrast fushata për raundin e dytë vazhdoi menjëherë pas ditës së zgjedhjeve më 17 tetor dhe zgjati deri më 29 tetor deri në mesnatë dhe raundi i dytë i zgjedhjeve lokale u zhvillua më 31 tetor ndërsa rivotimi është bërë në një vendvotim në Komunën e Dibrës, ndërsa votimi është shtyrë në komunat Mavrovë dhe Rostushë dhe Qendër Zhupë, për shkak të pjesëmarrjes së ulët të zgjedhësve ku partië politike përdorën në masë të madhe metodat e zakonshme të promovimit, si: mitingje, takime me qytetarë, fushatë “derë më derë”, reklama televizive, si dhe reklamat dhe promovimin e kandidaturave në rrjetet

---

<sup>53</sup> Për më tepër shih në ueb faqen e Levica: <https://levica.mk/>.

<sup>54</sup> Po aty.

sociale, pjesëmarrjen në debate televizive dhe billborde nga kandidatët dhe përveç fokusit në rritje në çështjet mjedisore, temat kryesore që mbizotëruan në fushatën parazgjedhore të këtyre zgjedhjeve lokale ishin të lidhura me politikën nacionale dhe ndërkombëtare, sikurse janë: aspiratat e kahershme të RMV-së për anëtarësim në BE dhe vonesa e vazhdueshme në fillimin e bisedimeve të anëtarësimit, mosmarrëveshjet mbi mënyrën se si qeveria e menaxhon pandeminë Covid-19, si dhe situata ekonomike, veçanërisht shkalla e lartë e papunësisë dhe emigracioni<sup>55</sup>.

Gjatë fushatës parazgjedhore u premtua efikasiteti i gazifikimit, deponive ilegale, burimet e rinovueshme të energjisë për ekonomitë familjare, shtigjet për biçikleta dhe gjelbërimi urban, si dhe projekte mjedisore, përfshirë modelet e transportit publik, të cilat u premtuan nga kandidatët për kryetarë komune për qytetet më të mëdha dhe kryeqytetin e Shkupit<sup>56</sup>.

Sipas OSBE/ODIHR-it, fushata u vlerësua si aktive dhe përgjithësisht e qetë pavarësisht incidenteve të izoluar, ku pandemia Covid-19 ndikoi në fushatën parazgjedhore, duke i detyruar pjesëmarrësit t'u përmbahen protokoleve të sigurisë së qeverisë për tubimet publike, dhe sipas saj të drejtat dhe liritë themelore, si e drejta e tubimit të qetë dhe e lëvizjes, përgjithësisht u respektuan gjatë gjithë fushatës dhe pjesëmarrësit ishin të lirë të bënin fushatë parazgjedhore, mirëpo, megjithatë, ka pasur më shumë raste të retorikës negative, e drejtuar shpesh kundër kundërshtarëve politik ku përdorimi i një retorike të tillë u intensifikua gjatë vetë fushatës, pavarësisht se kandidatët u zotuan t'i përmbahen Kodit të Zgjedhjeve të Drejta dhe Demokratike, të nënshkruar më 23 shtator 2021, prandaj, konkluzioni i OSBE/ODIHR është se zgjedhjet ishin paqësore me një avantazh sistemik për partitë e mëdha politike, ndërsa ditët e zgjedhjeve, duke përfshirë edhe numërimin e votave, u vlerësuan në përgjithësi pozitive, pavarësisht problemeve të shpeshta me pajisjet biometrike, votimin në grup dhe disa gabime procedurale në numërim, ku u vunë re probleme me fshehtësinë e votimit dhe votimi i gjerë në grup, të cilat ndikuan në pjesëmarrjen e grave në procesin zgjedhor, ndërkaq, për numërimin e votave, në raportin paraprak thuhet se është vlerësuar pozitivisht në shumicën e qendrave të

---

<sup>55</sup> Мисија за набљудување на изборите на ОДИХР Република Северна Македонија - локални избори, 17 октомври 2021 г. Изјава за прелиминарни наоди и заклучоци.

<sup>56</sup> Сега и официјално почна кампањата за локалните избори “, Радио Слободна Европа, 27.09.2021.

votimit, ku thuhet se makinat me gjurmë gishtash kanë ngadalësuar votimin dhe gjithashtu, ajo që vërejtën vëzhguesit ishte ndërhyrje e panevojshme në numërim nga përfaqësuesit e kandidatëve në zgjedhje<sup>57</sup>.

Nga ana tjetër, lidhur me financimin e fushatës parazgjedhore për këto zgjedhje lokale, vlen të theksohet se, sipas orarit zgjedhor, pjesëmarrësit në këto zgjedhje lokale duhej të dorëzonin katër raporte financiare të shpenzimeve të fushatës parazgjedhore<sup>58</sup>.

Raporti i parë financiar me formularin për donacionet e pranuar përfshin 10 ditët e para të fushatës zgjedhore dhe partitë dhe koalicionet janë obliguar ta dorëzojnë në ditën e njëmbëdhjetë të fushatës zgjedhore, gjegjësisht më 7 tetor deri në orën 24:00<sup>59</sup>.

Raporti i dytë financiar me formularin për donacionet e pranuar mbulon gjysmën e dytë të fushatës zgjedhore dhe partitë dhe koalicionet ishin të obliguara ta dorëzojnë një ditë pas përfundimit të fushatës zgjedhore, pra më 16 tetor për të parën dhe më 30 tetor për fushatën zgjedhore të raundit të dytë<sup>60</sup>.

Raporti i tretë financiar mbulon të hyrat dhe shpenzimet nga dita e hapjes së llogarisë së transaksionit të partive deri në përfundimin e raundit të parë zgjedhor ku partitë politike ishin të obliguara që këtë raport ta dorëzojnë jo më vonë se data 4 nëntor për raundin e parë, përkatësisht deri më 18 nëntor për raundin e dytë të zgjedhjeve<sup>61</sup>.

Raportin e katërt financiar, i cili i referohet totalit të të hyrave dhe shpenzimeve gjatë gjithë fushatës parazgjedhore, partitë dhe koalicionet duhet ta dorëzonin menjëherë dhe jo më vonë se 30 ditë nga dita e mbylljes së llogarisë së transaksionit<sup>62</sup>.

Sipas raporteve të dorëzuara financiare, koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE ka shpenzuar më së shumti mjete në fushatën parazgjedhore, gjegjësisht 1.695003 euro.

Partia e dytë sipas shumës së mjeteve të shpenzuara është koalicioni i udhëhequr nga LSDM, i cili ka shpenzuar gjithsej 1.632700 euro.

---

<sup>57</sup> Мисија за набљудување на изборите на ОДИХР Република Северна Македонија - локални избори, 17 октомври 2021 г. Изјава за прелиминарни наоди и заклучоци; „Потпишан Кодекс за фер и демократски избори“, Ohridnews, 23 септември 2021.

<sup>58</sup> Për më tepër shih në: Известување до учесниците на Локалните избори, Државен завод за ревизија, 2021.

<sup>59</sup> По ату.

<sup>60</sup> По ату.

<sup>61</sup> По ату.

<sup>62</sup> По ату.

E treta për nga të hyrat dhe shpenzimet në fushatë është BDI, e cila gjatë fushatës zgjedhore ka shpenzuar gjithsej 1.184218 euro kurse pas saj, për nga shuma e shpenzimeve është Danela Arsovska, e cila si kandidatë e pavarur për kryetare të qytetit të Shkupit ka raportuar shpenzime prej 211877 euro, ndërkaq, partia politike Lëvizja Besa ka shpenzuar për zgjedhjet 164360 euro, ndërsa PDSH për këto zgjedhje ka mbledhur gjithsej 54837 euro kure, Levica për zgjedhjet ka shpenzuar 51744 euro, ndërsa Koalicioni “Aleanca për Shqiptarët dhe Alternativa” ka raportuar si shpenzime 39416 euro<sup>63</sup>.

### 3.5. Rezultatet e zgjedhjeve lokale të tetorit 2021

#### 3.5.1. Rezultatet e zgjedhjeve lokale për kryetarë komunash në nivel të 80-të komunave

Në të dy raundet numrin më të madh të ulëseve për kryetar komunash e fitoi VMRO-DPMNE e cila fitoi në 42 komuna, LSDM fitoi 16 mandate, BDI 11, dy kryetarë komunash fituan BESA, si dhe koalicioni Aleanca për Shqiptarët dhe Alternativa dhe një GROM dhe koalicioni për ndryshimin e LDP/DOM, ndërsa 3 ulëse për kryetar komune u takuan kandidatëve të pavarur në komunat e Kumanovës, Debarcës dhe Qytetit të Shkupit<sup>64</sup>.

TABELA 2<sup>65</sup>:

#### Rezultatet e zgjedhjeve lokale për kryetarë komunash në nivel të 80-të komunave

Partia politike	VMRO-DPMNE	LDSM	BDI	ASH-A	Të pavarur	Besa	LDP-DOM	GROM
Numri i kryetarëve të komunave	42	16	11	3	3	2	1	1

<sup>63</sup> Për më tepër shih në: Известување до учесниците на Локалните избори, Државен завод за ревизија, 2021.

<sup>64</sup> Për më tepër shih në: Резултати на локални избори 2021, Државна изборна комисија. Резултати од прв и втор круг.

<sup>65</sup> Për më tepër shih në: Резултати на локални избори 2021, Државна изборна комисија. Резултати од прв и втор круг.

### 3.5.2. Rezultatet e zgjedhjeve lokale për këshilltarë komunalë në nivel të 80-të komunave

Për zgjedhjen e këshilltarëve lokal në komuna, VMRO-DPMNE doli e para duke fituar gjithsej 469 vende në këshilla komunal, LSDM 402, BDI 167, Koalicioni Aleanca për Shqiptarët dhe Alternativa fitoi 81, Levica fitoi 49, BESA 36, Koalicioni "Të vendosur për ndryshim" fitoi 29, DPTM fitoi 17, PDSH fitoi 9, lista e këshilltarëve të BDI-së dhe Aleancës për Shqiptarët dhe Alternativës, me të cilën këto parti performuan së bashku në komunën e Çashkës fitoi 4 vende këshilltarësh, TMRO: 3, GROM: 2, SRM: 2, PDT: 2, DNET: 2 dhe nga një këshilltar fituan: DSR, Maqedonia e Bashkuar, Podem, BDS, DDPS dhe "Rom-Romeske", ndërkaq, kandidatët e pavarur fituan gjithsej 67 vende në këshill, nga të cilat: "Për Kumanovën tonë" fitoi 8 vende, "Shansi për Qendrën" - 3, "Ndryshe" në Komunën e Manastirit fitoi 3 vende, "Qyteti i Gjëlber Njerëzor" në Këshillin e Qytetit të Shkupit – 2; "Për mbrojtjen e Karposhit" - 2, "Më mirë për Tetovën" - 2, "VJEN E - Fronti kundër minierës dhe ndotësve të mjedisit" fitoi nga një përfaqësues në Këshillat komunalë Novosellë, Bosilovë dhe Strumicë, me çrast përveç komunave të përmendura, në listat e pavarura janë përfshirë edhe këshilltarët në komunat vijuese: Bogdanci, Gjevgjeli, Debarcë, Demir Kapi, Dollneni, Ilinden, Kavadar, Kërçovë, Koçan, Kratovë, Likovë, Lozovë, Makedonska Kamenica, Makedonski Brod, Mogilla, Ohër, Petrovec Pehçevë, Probishtip, Radovish, Rankovcë, Sveti Nikollë, Staro Nagoriçan, Çeshinovë-Obleshevë dhe Çucer Sandevë<sup>66</sup>.

Rezultatet e mësipërme do ti paraqesim edhe në formë tabelare si vijon:

**TABELA 3:**

#### **Rezultatet e zgjedhjeve lokale për këshilltarë komunalë në nivel të 80-të komunave (mbi 10-të këshilltarë)**

<b>Partia politike</b>	<b>VMRO-DPMNE</b>	<b>LDSM</b>	<b>BDI</b>	<b>ASH-A</b>	<b>Të pavarur</b>	<b>Levica</b>	<b>Besa</b>	<b>LDP-DOM</b>	<b>DPTM</b>
Numri i këshilltarëve të fituar	469	402	167	81	67	49	36	29	17

<sup>66</sup> Për më tepër shih në: Резултати на локални избори 2021, Државна изборна комисија. Резултати од прв и втор круг.

### 3.5.3. Rezultatet e zgjedhjeve lokale për Kryetar të Qytetit të Shkupit

Në qytetin e Shkupit për pjesëmarrje në zgjedhjet lokale janë dorëzuar 12 kandidatura për kryetarë komunash, 15 lista për këshilltarë për Këshillin e Qytetit të Shkupit, 49 kandidatura për kryetarë komunash për komunat në qytetin e Shkupit dhe 95 lista për këshilltarë për këshillat e komunave të Qytetit të Shkupit, ndërsa në komunat Qendër, Karposh, Gazi Babë dhe Qytetin e Shkupit, listat e këshilltarëve të pavarur i kanë dorëzuar edhe iniciativat qytetare Shansi për Qendër, Të Pavarurit për Karposh, Të Gjelbrit nga Gazi Baba dhe Qyteti i Gjelbër Njerëzor<sup>67</sup>.

**TABELA 4<sup>68</sup>:**

#### Rezultatet zgjedhore për Kryetar të Qytetit të Shkupit në raundin e parë zgjedhor

Kandidati	Partia politike	Votat e fituara
Danela Arsovska	E pavarur/e mbështetur nga VMRO-DPMNE dhe ASH-A	86.698
Petre Shilegov	LDSM	78.783
Petar Georgievski	Levica	20.609
Ana Petrovska	Qyteti i gjelbër human	9.954
Arben Shakiri	DOM-LDP	8.911
Aleksandar Torteovski	Tvoja Partija	2.669
Vladimir Trajkovski	Rodna Makedonija	1.739
Munir Kolashinac	BDS	1.681
Todor Noshpal	Integra	1.332
Goran Arsovski	KPM-TS	660
Slave Nestorovski	TMRO	613
Ljubomir Josifovski	Demokratët	439

<sup>67</sup> Për më tepër shih në: Rezultati na lokalni izbori 2021, Dржавна изборна комисија. Резултати од прв и втор круг.

<sup>68</sup> Për më tepër shih në: Резултати на локални избори 2021, Државна изборна комисија. Резултати од прв и втор круг.



**TABELA 5<sup>69</sup>:****Rezultatet zgjedhore për Kryetar të Qytetit të Shkupit në raundin e dytë zgjedhor**

Kandidati	Partia politike	Votat e fituara
Danela Arsovska	E pavarur/e mbështetur nga VMRO-DPMNE dhe ASH-A	118.749
Petre Shilegov	LDSM	90.672

**3.5.4. Rezultatet e zgjedhjeve lokale për këshilltarë komunalë në Këshillin e Qytetit të Shkupit**

Për zgjedhjen e këshilltarëve në qytetin e Shkupit, VMRO-DPMNE ka fituar 79.622 vota (34,6%), LDSM 53.354 (23.2%), BDI 26.379 (11.5%), Levica 20.346 (8,9%), Aleanca për Shqiptarët dhe Alternativa 11450 (5%), Të vendosur për ndryshim LDP-DOM 9324 (4%) dhe Qyteti i Gjellbër Human 9230 (4%). Rrjedhimisht, nga gjithsej 45 këshilltarë në Këshillin e Qytetit të Shkupit, VMRO-DPMNE fitoi 18, LDSM 12, BDI 5, Levica 4 këshilltarë. Koalicioni Aleanca për Shqiptarët dhe Alternativa, Koalicioni “Të vendosur për ndryshim” dhe “Qyteti i Gjellbër Human” kanë nga dy këshilltarë<sup>70</sup>. Në vijim, rezultatet e mësipërme do ti paraqesim në formë tabelare.

**TABELA 6<sup>71</sup>:****Rezultatet e zgjedhjeve lokale për këshilltarë komunalë në Këshillin e Qytetit të Shkupit**

Partia politike	Votat e fituara	Vende këshilltarësh
VMRO-DPMNE	79.622	18
LDSM	53.354	12
BDI	26.379	5
LEVICA	20.346	4
ASH-A	11.450	2
LDP-DOM	9.324	2
Qyteti i gjellbër human	9.230	2
Totali i vendeve		45

<sup>69</sup> Për më tepër shih në: Rezultati na lokalni izbori 2021, Dржавна изборна комисија. Резултати од прв и втор круг.

<sup>70</sup> Po aty.

<sup>71</sup> Po aty.

### 3.5.5. Jehona e zgjedhjeve lokale të tetorit 2021 dhe analiza krahasimore me zgjedhjet paraprake lokale

Ajo që është karakteristike për zgjedhjet e shtata lokale të v. 2021 është jehona më e ulët e këtyre zgjedhjeve me vetëm 49% në raundin e parë, në tërë historikun e zgjedhjeve lokale në RMV.

Bazuar në rezultatet e publikuara nga KSHZ për të gjithë shtatë zgjedhjet lokale të mbajtuara deri më tani, në vijim do ti paraqesim në formë tabelare të dhënat lidhur me jehonën zgjedhore në shtatë ciklet zgjedhore lokale.

TABELA 7<sup>72</sup>:

#### Jehona e shtatë zgjedhjeve lokale në RMV-Raundi i parë

Viti i zgjedhjeve lokale	1996	2000	2005	2009	2013	2017	2021
Jehona e zgjedhjeve lokale-Raundi i parë	60%	59%	56%	57%	67%	60%	49%

### 3.6. Mbrojtja juridike e së drejtës zgjedhore në zgjedhjet lokale të tetorit 2021

Kodi Zgjedhor garanton mbrojtjen e të drejtës zgjedhore me çrast sipas tij, çdo parashtrues i listës së kandidatëve dhe çdo votues ka të drejtë të paraqesë ankesë në Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve nëse konsideron se i është shkelur e drejta zgjedhore dhe ankesat nga parashtruesit e listave mund të kenë të bëjnë me procedurën e votimit, tabelimin dhe përcaktimin e rezultateve, ndërsa votuesit mund të paraqesin ankesë nëse në procedurë u

<sup>72</sup> Për më tepër shih në: Марко Панковски; Никола Михајловски; Ива Наскова; Здравко Ставров, Прирачник за локални избори во Република Северна Македонија 2021 година, Второ дополнето издание, декември 2021, КАС, Скопје, стр. 33.

është shkelur e drejta zgjedhore, me çrast procedura për mbrojtjen e të drejtës zgjedhore është urgjente, për çka në këtë rast ankesa dhe padia nuk mund të dërgohet me postë kurse ankesat e dorëzuara nga parashtruesit e listave në KSHZ duhet të dorëzohen në afat prej 48 orëve pas përfundimit të votimit, përkatësisht pas shpalljes së rezultateve fillestare, dhe KSHZ-ja është e obliguar të vendosë në afat prej 48 orëve pas pranimit të ankesës ndërkaq, vendimi i marrë nga KSHZ-ja do t'i njoftohet parashtruesit të ankesës me e-mail dhe vendimi konsiderohet se është dorëzuar në afat prej pesë orëve nga dërgimi i postës elektronike, ku ankuesi, i cili ka marrë përgjigje negative nga KSHZ, ka të drejtë të paraqesë padi në Gjykatën Administrative në afat prej 24 orëve pas pranimit të vendimit dhe, Gjykata Administrative duhet të marrë vendim brenda 60 orëve nga marrja e padisë me atë që Gjykata Administrative mund ta konfirmojë apo ta ndryshojë vendimin e KSHZ-së, me çka vendimet e saj janë të formës së prerë, përkatësisht kundër tyre nuk mund të parashtrohet më ankesë apo mjet tjetër juridic dhe në rast të shkeljes së të drejtës zgjedhore të votuesit, ai/ajo mund të parashtrojë ankesë në KSHZ në afat prej 24 orëve, ndërsa KSHZ-ja është e obliguar të vendosë brenda 4 orëve pas pranimit të ankesës dhe, vendimi i KSHZ-së mund të ankimohet, kështu që në afat prej 24 orëve pas pranimit të vendimit do të paraqitet padi në Gjykatën Administrative<sup>73</sup>.

Për dy raundet e zgjedhjeve të shtata lokale të v. 2021, në Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve janë dorëzuar gjithsej 1053 ankesa për procedurën e votimit. Pjesa më e madhe e tyre, 989, ishin ankesa të qytetarëve në lidhje me mbrojtjen e të drejtës zgjedhore. Gjithashtu, janë parashtruar 27 ankesa për mbrojtjen e të drejtës zgjedhore të parashtruesit të autorizuar për procedurën e përmbljedhjes dhe përcaktimit të rezultateve. Janë paraqitur 35 ankesa për mbrojtjen e të drejtës së votimit të një parashtruesi të autorizuar për procedurën e votimit. Dy ankesa janë paraqitur për mos respektim të dispozitave për aktivitetet dhe kohëzgjatjen e fushatës parazgjedhore. Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve ka miratuar 392 ankesa, ka refuzuar 103 dhe ka hedhur poshtë 56 sish. 29 ankesa janë tërhequr, ndërsa pjesa tjetër janë ende të pahapura ose në pritje<sup>74</sup>.

---

<sup>73</sup> Për më tepër shih në: Kodi zgjedhor i RMV-së: Propozimi i tekstit të konsoliduar) në dispozicion në linkun: [https://drive.google.com/file/d/1Sa9L6emhxl2VaV\\_8d7oK3hJ6r1usnuY/view](https://drive.google.com/file/d/1Sa9L6emhxl2VaV_8d7oK3hJ6r1usnuY/view).

<sup>74</sup> Për më tepër shih në: Државна изборна комисија, Преглед на приговори. Në dispozicion në: <https://prigovori.sec.mk/objections/objections>.

Misioni i OSBE/ODIHR vuri në dukje se KSHZ-ja nuk i respektoi afatet për shqyrtimin e ankesave dhe se sistemi elektronik i ankesave të KSHZ-së nuk përditësohej vazhdimisht, duke ndikuar në informimin publik dhe transparencën e procesit. Nga gjithsej 1053 ankesa, para rrethit të parë të zgjedhjeve, deri më 15 tetor, në KSHZ janë dorëzuar 23 ankesa, nga të cilat 17 janë pranuar. Shumica e këtyre ankesave janë bërë nga qytetarët për mbrojtjen e të drejtës zgjedhore, më së shpeshti lidhur me pamundësinë për të votuar të të sëmurëve dhe të dobëtit, si dhe të personave të infektuar me koronavirus. Në ditën e zgjedhjeve në raundin e parë janë paraqitur mbi 300 ankesa nga qytetarët, kryesisht për shkak të pamundësisë për të qenë në Listën zgjedhore. Përpara raundit të dytë, votuesit paraqitën 122 ankesa shtesë për të drejtat e tyre të votimit dhe votimin nga shtëpia. Gjithashtu, pas rrethit të parë, KSHZ shqyrtoi dhe refuzoi 14 ankesa, prej të cilave 2 për shkelje të heshtjes parazgjedhore dhe 12 ankesa për rezultate<sup>75</sup>.

Nga ana tjetër, për raundin e parë të këtyre zgjedhjeve, në Gjykatën Administrative janë pranuar gjithsej 28 padi, ndërsa një padi e VMRO-DPMNE-së është pranuar për dhënie rryshfeti ndaj votuesve në zgjedhjet për anëtarë të Këshillit të Qytetit të Shkupit, në vendvotimin 2461 në Komunën e Shkupit-Saraj. Gjykata Administrative pranoi edhe dy padi të tjera nga Aleanca e Shqiptarëve dhe Alternativa dhe Lëvizja “Të vendosur për ndryshim”. Me pranimin e padisë së Aleancës së Shqiptarëve dhe Alternativës, janë anuluar rezultatet e votimit në vendvotimin 0543 në Dibër me 777 votues, që mund të përcaktojë fituesin e zgjedhjeve. Lidhur me padinë e Lëvizjes “Të vendosur për ndryshim”, janë anuluar rezultatet nga vendvotimi 2957/1 në Komunën e Shuto Orizares. Pas vendimeve të tilla të Gjykatës Administrative, në këto qendra votimi u mbajt një rivotim për rrethin e parë<sup>76</sup>.

Ndërkaq, në raundin e dytë janë paraqitur 16 padi, prej të cilave është pranuar vetëm padia e BESA-së lidhur me pranimin e kundërshtimit të BDI-së nga KSHZ-ja për Vendvotimin 2107 në Komunën e Zhelinës. Gjykata vendosi që në këtë vendvotim të mos ketë rivotim, duke konfirmuar fitoren e kandidatit të BESA-s, Blerim Sejdiu.

---

<sup>75</sup> Për më tepër shih në: Изјава за прелиминарни наоди и заклучоци, ОБСЕ/ОДИХР, втор круг, 31 октомври 2021.

<sup>76</sup> Për më tepër shih në: Управен суд, Судски портал на Република Северна Македонија, në dispozicion në: <http://www.vsrn.mk/wps/portal/usskopje>.

### 3.7. Vlerësimet e zgjedhjeve lokale të tetorit 2021

Gjithsej 1257 vëzhgues vendorë, përkthyes, vëzhgues ndërkombëtarë dhe gazetarë të huaj u akredituan për të mbuluar zgjedhjet lokale të vitit 2021<sup>77</sup>.

Numri i vëzhguesve vendorë në këto zgjedhje ishte 871 ku më të përfaqësuar ishin vëzhguesit e Organizatës Civile AXIOS 2017 Shkup, numri i të cilëve ishte 529 vëzhgues dhe, më pas vijonin Asociacioni i qytetarëve CIVIL-Qendra për Liri Shkup me 284 vëzhgues, Shoqata për afirmimin e vlerave njerëzore dhe integrimin e të rinjve Mak-Sonce-Shkup me 31 vëzhgues, Instituti për strategji ekonomike dhe marrëdhënie ndërkombëtare Ohër-Shkup me 12 vëzhgues, Qendra Kombëtare Rome me 10 vëzhgues, Parandalimi Qytetar "Parandalimi gjatë zgjedhjeve" me 4 dhe Asociacioni i Federalistëve të Rinj Evropianë-JEF Maqedonia e Veriut me 1 vëzhgues<sup>78</sup>.

Në një deklaratë mbi gjetjet dhe konkluzionet paraprake të OSBE/ODIHR për raundin e parë të zgjedhjeve lokale të v. 2021, u theksua se, zgjedhjet u mbajtën në frymë konkurruese dhe liritë themelore u respektuan gjerësisht mirëpo, megjithatë, në deklaratë thuhet se mangësitë e shumta në kuadrin ligjor nënvizojnë nevojën për një reformë gjithëpërfshirëse të sistemit zgjedhor sepse vihet re se partitë kryesore parlamentare gëzojnë avantazhe sistematike, veçanërisht në aspektin e ndarjes së burimeve publike për fushatë parazgjedhore me çrast gjithashtu thuhet se zbatimi i vonuar i identifikimit biometrik të votuesve ka krijuar sfida shtesë në zhvillimin e këtyre zgjedhjeve<sup>79</sup>.

Transparenca e informacionit të votimit gjatë gjithë ditës, së bashku me rezultatet paraprake për çdo qendër votimi natën e zgjedhjeve, ka përmirësuar transparencën dhe miratimi i një sërë ndryshimesh në Kodin Zgjedhor pa debat publik apo konsultim me palët kryesore të interesuara në lidhje me këto zgjedhje vlerësohet si në kundërshtim me praktikën ndërkombëtare por, megjithatë, thuhet se ata kanë kontribuar në zbatimin e disa rekomandimeve të mëparshme të OSBE/ODIHR-it, si: përcaktimi i mandatit të anëtarëve të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe lejimi i qytetarëve të cilëve u ka skaduar karta e

<sup>77</sup> Akreditirани набљудувачи - Избори 2021, Државна изборна комисија.

<sup>78</sup> Për më tepër shih në: Марко Панковски; Никола Михајловски; Ива Наскова; Здравко Ставров, Прирачник за локални избори во Република Северна Македонија 2021 година, Второ дополнето издание, декември 2021, КАС, Скопје, стр. 74.

<sup>79</sup> Изјава за прелиминарни наоди и заклучоци на Мисија на набљудување на изборите на ОДИХР - локални избори, 17 октомври 2021.

identitetit pas shpalljes së zgjedhjeve, ku poashtu thuhet se, në këto zgjedhje u përdor për herë të parë identifikimi biometrik i zgjedhësve pa kryer një projekt pilot apo testim dhe sipas deklaratës së OSBE/ODIHR-it, korniza e shkurtër e zbatimit e pengoi KSHZ-në të miratonte menjëherë aktet nënligjore, procedurat, trajnimin dhe edukimin e votuesve mirëpo, megjithatë, shumica e bashkëbiseduesve të Misionit Ndërkombëtar të Vëzhgimit të ODIHR-it, përfshirë partitë politike, mirëpritën futjen e identifikimit biometrik të votuesve si një mjet efektiv për parandalimin e mashtrimit zgjedhor me çrast sipas misionit të OSBE/ODIHR-it, procesi i regjistrimit të kandidatëve ishte gjithëpërfshirës me gjithsej 299 kandidatë të regjistruar për kryetar komune dhe 571 lista për këshilltarë me 10.649 kandidatë ku edhe pse gratë përbënin rreth 45% të të gjithë kandidatëve për këshilltarë, në përputhje me detyrimin ligjor për përfaqësimin gjinor, dhe mbanin 111 lista, vetëm 8 për qind e kandidatëve për kryetar komune ishin gra, andaj çështjet që lidhen me barazinë gjinore dhe të drejtat e grave mungonin kryesisht në platformat dhe fjalimet e kandidatëve dhe gratë ishin të nënpërfaqësuar në fushatat partiake, kurse nga ana tjetër, misioni i OSBE/ODIHR vuri në dukje raste të izoluara të frikësimit të kandidatëve, por kishte gjithashtu pretendime për presion ndaj kandidatëve të caktuar për t'u tërhequr nga procesi zgjedhor, si dhe disa pretendime të besueshme për presion ndaj votuesve dhe blerje votash<sup>80</sup>.

Në Deklaratën e gjetjeve dhe konkluzioneve paraprake të Misionit të OSBE/ODIHR-it për raundin e dytë të zgjedhjeve lokale të v. 2021, theksohet se, ka pasur një fushatë konkurruese në të cilën janë respektuar liritë themelore por, megjithatë, krahasuar me raundin e parë, retorika negative dhe raportet për frikësimin e kandidatëve dhe presionin ndaj votuesve potencialisht e kanë shtyrë procesin prapa ku vërehet se administrata zgjedhore bëri përpjekje për të adresuar mangësitë procedurale të vërejtura gjatë raundit të parë dhe se raundi i dytë i zgjedhjeve u zhvillua pa probleme me disa kufizime, kryesisht për ankesa, me çrast për raundin e dytë, OSBE/ODIHR vlerësoi se ishte konkurrues dhe se kandidatët ishin përgjithësisht të lirë për të bërë fushatë dhe për të përcjellë mesazhe mirëpo, megjithatë, rastet me retorikë negative ndikuan në atmosferën e përgjithshme dhe partitë kryesore sulmuan njëra-tjetrën

---

<sup>80</sup> Изјава за прелиминарни наоди и заклучоци на Мисија на набљудување на изборите на ОДИХР - локални избори, 17 октомври 2021.

ndërsa procesi i votimit në vendvotimet e vizituara u vlerësua si i mirëorganizuar, transparent dhe paqësor me incidente të izoluara dhe në disa raste me shkelje të fshehtësisë së votimit<sup>81</sup>.

Në këtë kontekst, duhet theksuar se, më 31 tetor 2021, pas shpalljes së rezultateve të raundit të dytë të zgjedhjeve lokale, kryeministri Zoran Zaev dha dorëheqje nga posti i kryeministrit dhe liderit të partis LSDM, duke theksuar se merr përgjegjësinë dhe jep dorëheqjen si kryeministër dhe Kryetar i LSDM-së, duke uruar të gjithë qytetarët përparimtarë që luftuan fort për Maqedoninë e Veriut të integruar, por theksoi se është i zhgënjyer sepse shumica e njerëzve që votuan, si dhe ata që qëndruan në shtëpi, zgjodhën të njëjtët njerëz dhe politikanë që në Parlament para katër vitesh donin të shkonin dhe të vrisnin, madje disa prej tyre janë zgjedhur edhe kryetarë komunash në Shkup dhe komuna të tjera, duke theksuar se të gjithë kemi parë një aleancë mes viktimave dhe banditëve, pa fytyrë, vetëm për pushtet dhe para, dhe tha se, tërheqja e tij nga politika duhet të mbahet mend nga populli, sepse nuk është e vështirë të largohesh nga politika, por është e vështirë të mendosh për realitetin e vendimit<sup>82</sup>.

Edhe pse kjo dorëheqje nuk u prit aq mirë në opinion, ajo u zyrtarizua në Kuvend dhe më 16 janar 2022, Maqedonia e Veriut fitoi Qeverinë e re dhe kryeministër të ri, Dimitar Kovačevski<sup>83</sup>.

Siç analizon gazetari Popovski, çfarë duhet të kishte bërë Emanuel Macron pas zgjedhjeve rajonale dhe komunale sepse partia e tij nuk fitoi asnjë rajon, dhe socialistët e udhëheqin Parisin që nga viti 2001 pa ndërprerje, ose në zgjedhjet lokale të 2021 në Spanjë, konservatorët e ruajtën triumfalisht pushtetin në Madrid, ndaj kryeministri Pedro Sanchez nuk mendoj se kjo duhej të ishte arsyeja e dorëheqjes së tij dhe as që e kërkoi askush ose Vjena e cila ka pasur një kryebashkiak të krahut të majtë për dekada, dhe vendi është qeverisur nga një qeveri konservatore për shumicën e atyre viteve, ose Viktor Orban, i cili humbi zgjedhjet lokale të 2019-ës nga kandidatët e bashkuar të opozitës në 10 nga 15 qytetet më të mëdha, përfshirë Budapestin, ose çfarë duhet të kishte bërë Andrej Plenković në Kroaci, kur këtë vit fitoi në Zagreb Tomislav Tomasevic nga koalicioni i majtë i gjelbër; ose, politikani laburist Sadiq Khan, i

---

<sup>81</sup> Изјава за прелиминарни наоди и заклучоци на Мисија на набљудување на изборите на ОДИХР - втор круг на локалните избори, 31 октомври 2021.

<sup>82</sup> "Zaev resigned from the post of Prime Minister and leader of the party", Deutsche Welle in Macedonian, 31.10.2021.

<sup>83</sup> "North Macedonia Gets New Prime Minister", Voice of America, 16.01.2022.

cili fitoi një mandat të dytë si Kryetar i Londrës në v. 2021, ndërsa konservatori Boris Johnson mbeti kryeministër i Britanisë dhe nuk mendoi të jepte dorëheqjen<sup>84</sup>.

---

<sup>84</sup> "Why is Zaev putting his position at stake before the second round of local elections?" Deutsche Welle in Macedonian, 27.10.2021.



## KONKLuzionet

Në këtë punim të masterit u trajtuan aspektet kushtetuese, ligjore, teorike dhe praktike të zgjedhjeve lokale dhe sistemit zgjedhor të RMV-së. Në kuadër të aspektit teorik u trajtua edhe historiku i zgjedhjeve lokale në RMV dhe u konstatua se, duke marrë parasysh rëndësinë që kanë zgjedhjet lokale për një vend demokratik, gjithmonë ka vend për plotësime dhe reforma zgjedhore.

U konstatua se, në përgjithësi se sistemi zgjedhor në RMV parimisht është në përputhje me standartet ndërkombëtare dhe europiane, se zgjedhjet e shtata lokale në RMV e kishin rolin e zgjedhjeve nacionale për shkak të dorëheqjes së Kryeministrit Zaev dhe ndryshimit të Qeverisë dhe se këto zgjedhje ishin kredibile dhe kompetitive, mirëpo megjithatë partitë kryesore parlamentare gëzojnë avantazhe sistematike, veçanërisht në shpërndarjen e burimeve publike për fushatën parazgjedhore, duke përfshirë edhe mediat e shkruara dhe ato elektronike.

Për sa i përket historikut të zgjedhjeve lokale në RMV në veçanti, u konstatua si vijon:

Zgjedhjet e para lokale në Republikën e pavarur të Maqedonisë u mbajtën në vitin 1996, me dalje mesatare të votuesve për zgjedhjen e këshilltarëve për komunat 60,17%, ndërsa për qytetin e Shkupit 53,20%. Dalja mesatare e votuesve për kryetar komune ishte 60,28%, ndërsa për qytetin e Shkupit 53,20%. Gjatë këtyre zgjedhjeve votimi është anuluar në komuna të caktuara, kështu që në këto të dhëna nuk përfshihen rezultatet e zgjedhjes së kryetarëve të komunave apo anëtarëve të këshillit në gjithsej 9 komuna. Këto zgjedhje lokale janë mbajtur sipas organizimit territorial të vitit 1996, sipas të cilit janë formuar 123 komuna dhe Qyteti i Shkupit si njësi e veçantë e vetëqeverisjes lokale. Kështu, LSDM-ja fitoi numrin më të madh të vendeve për kryetar komune: 51, VMRO-DPMNE dhe MAAK-konservatore: 27, dhe Partia Socialiste: 19.

Zgjedhjet e dyta lokale të vitit 2000 kishin një numër të konsiderueshëm shkeljesh të procesit zgjedhor dhe standardeve ndërkombëtare për zgjedhje të lira dhe demokratike. Zgjedhjet kishin një sërë incidentesh, dhunë dhe frikësim të votuesve. Në disa komuna: Gostivar, Tetovë, Labunishtë, Xhepçishtë dhe Mavrovi Anovi, zgjedhjet u pasuan me incidente të armatosura. Në disa qendra votimi në komuna të tjera, kutitë e votimit janë hapur dhe

shkatërruar me forcë. Në raundin e dytë të votimit u përsërit dhuna në vende të ndryshme. OSBE/ODIHR regjistroi votimin në grup në 25% të qendrave të votimit të vëzhguara, votim të hapur në 8% dhe votim në emër të një tjetri në 5%. Pas këtyre zgjedhjeve, KSHZ nuk i publikoi rezultatet e plota dhe gjithëpërfshirëse të zgjedhjeve. Në raundin e parë, koalicioni “Për Maqedoninë së bashku”, i udhëhequr nga LSDM, fitoi 38% të votave për kryetarë komunash, ndërsa koalicioni VMRO-DPMNE dhe Alternativa Demokratike fituan 27%, PDSH 13% dhe PDP 6%. Rezultatet përfundimtare treguan fitore për koalicionin e VMRO-DPMNE-së dhe Alternativës Demokratike, “Për Ndryshim”, në 48% të komunave, gjegjësisht fituan 59 pozita të kryetarëve të komunave, ndërsa koalicioni i udhëhequr nga LSDM “Për Maqedoninë së bashku” fiton 32 pozita të kryetarëve të komunave.

Zgjedhjet e treta lokale të 2005 përsëri nuk arritën të përmbushin standardet kryesore ndërkombëtare për universalitetin, barazinë dhe fshehtësinë e votës. Për dallim nga zgjedhjet e mëparshme, këto zgjedhje nuk u karakterizuan me dhunë, por një sërë parregullsish janë vërejtur në pjesën perëndimore, veriperëndimore të vendit dhe në Shkup. Në të njëjtën kohë, zgjedhjet e vitit 2005 janë të parat që janë mbajtur nën organizimin territorial të vitit 2004, i cili themeloi 84 komuna në territorin e Maqedonisë dhe e ruajti statusin e qytetit të Shkupit si njësi e veçantë e vetëqeverisjes lokale. Vëzhguar nga OSBE/ODIHR, u konstatuan 30 raste të mbushjes së kutive të votimit dhe mbi 50 raste votimi në emër të një tjetri. Në 9 komuna, përfshirë edhe qytetin e Shkupit, si rezultat i ankesave për parregulsi në rrethin e parë të votimit, është dashur të përsëritet. Një raund i dytë votimi ishte planifikuar gjithashtu të zhvillohej në këto qendra votimi, duke rezultuar në një raund të dytë, i cili u zhvillua më 10 prill 2005. Pjesëmarrja e votuesve në raundin e parë ishte 56.36%, në raundin e dytë më 27 mars ishte 53.66%, dhe më 10 prill ishte 35.6%. Koalicioni i udhëhequr nga LSDM fitoi 36 vende për kryetar komune. VMRO-DPMNE dhe koalicioni fituan 21 ulëse për kryetar komune, BDI: 15, VMRO-NP: 3, PDSH: 2 dhe Unioni i Romëve: 1. Kryetar komune u bënë 7 kandidatë të pavarur, përfshirë edhe kandidatin për Shkupin, Trifun Kostovski, i cili u mbështet nga VMRO-DPMNE.

Zgjedhjet e katërta lokale të vitit 2009, të mbajtura në të njëjtën ditë me zgjedhjet presidenciale, janë zgjedhjet e para lokale që mbahen në përgjithësi në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe të OSBE-së për zgjedhje demokratike. Por, edhe për këto

zgjedhje, OSBE/ODIHR kishte vërejtje të forta për frikësimin e votuesve. Raporti i monitorimit i OSBE/ODIHR vë në dukje frikësimin dhe presionin ndaj votuesve, veçanërisht punonjësve të administratës publike dhe përfituesve të ndihmës sociale, të cilët janë kërcënuar se do të votojnë për partinë në pushtet. Në vitin 2009, sipas këtij misioni ndërkombëtar u konstatuan: votimi familjar, votimi në emër të një tjetri, i njëjti person duke "ndihmuar" më shumë se një votues, përpjekjet për të ndikuar tek votuesit, frikësimi i votuesve dhe anëtarëve të këshillave zgjedhore, nënshkrimet identike në ekstraktet nga Lista e Zgjedhësve dhe votimi i shumëfishtë. VMRO-DPMNE ishte fituese në 56 komuna, BDI në 15, LSDM në 7 dhe PDSH, ND, DPTM, SR, PDMSM fituan nga një kryetar komune. Dy kandidatë të pavarur fituan gjithashtu vende për kryetar komune.

Zgjedhjet e pesta lokale të vitit 2013 u zhvilluan në një atmosferë paqësore, duke marrë vlerësime pozitive për efikasitetin e zbatimit të tyre, ndonëse u evidentuan disa mangësi. Mangësitë më së shumti u theksuan në drejtim të kushteve të pamjaftueshme për të siguruar një fushë të barabartë konkurrimi ndërmjet kandidatëve. Në këtë kontekst, janë vërejtur dobësi në pjesën e mbivendosjes së aktiviteteve shtetërore dhe partiake, financimin e fushatave zgjedhore, kornizën ligjore, si dhe raportimin mediatik. Megjithatë, në raste të rralla, vërejtjet përfshinin gjithashtu shkelje të fshehtësisë së votimit, votimin familjar dhe shkatërrimin e materialit zgjedhor. Në media u bënë vërejtje serioze kryesisht në drejtim të ndarjes së tyre në vija etnike dhe partiake. Me këto zgjedhje hyri në fuqi organizimi i ri territorial, i cili për herë të parë zgjodhi kryetarë dhe këshilltarë në 81 komuna, sepse komunës së Kërçovës iu aneksuan komunat Vraneshticë, Drugovë, Zajas dhe Oslomej. Pjesëmarrja në këto zgjedhje ishte mjaft e lartë. Në raundin e parë ishte 67%, ndërsa në raundin e dytë që u mbajt në 29 komuna pjesëmarrja ishte 59%. Votimi i përsëritur ka pasur në komunën e Dollnenit, ndërsa për shkak të rezultateve të anuluar ka pasur rivotim të rrethit të dytë në katër komuna: Qendër, Dollneni, Strugë dhe Gjorçe Petrov. Pjesëmarrja në ditën e tretë të zgjedhjeve ishte 65%. Partia më dominuese në këto zgjedhje lokale ishte VMRO-DPMNE, e cila fitoi më së shumti kryetarë komunash në krahasim me partitë tjera. VMRO-DPMNE fitoi 56 ulëse për kryetar komune, BDI fitoi 14 kryetarë komunash, LSDM fitoi 4, PDSH fitoi 2, Partia Demokratike e Turqve, Partia

Progresive Serbe në Maqedoni dhe Bashkimi i Romëve të Maqedonisë fituan nga një kryetar komune si dhe u zgjodhën edhe dy kandidatë të pavarur për kryetarë komunash.

Më 15 tetor 2017 u mbajtën zgjedhjet e gjashta lokale që nga shpallja e pavarësisë së Republikës së Maqedonisë. Zgjedhjet u zhvilluan në 80 komuna dhe në qytetin e Shkupit, ku kryetarët e komunave dhe qytetit të Shkupit u votuan sipas sistemit zgjedhor të shumicës, ndërsa anëtarët e këshillave u zgjodhën sipas modelit zgjedhor proporcional. Të sëmuret, të pafuqishmit, personat në arrest shtëpiak dhe të burgosurit votuan një ditë para dy raundeve, pra më 14 dhe 28 tetor 2017. Gjithsej 1.079876 nga gjithsej 1.814644 votues të regjistruar në listën e zgjedhësve dolën në votime, duke e çuar pjesëmarrjen në raundin e parë në 59.51%, ndërkaq, në raundin e dytë të zgjedhjeve pjesëmarrja u ul në 51.92%. Sipas dinamikës së mëparshme, zgjedhjet lokale në Republikën e Maqedonisë mbaheshin çdo katër vjet në gjysmën e dytë të marsit. Megjithatë, për shkak të trazirave dhe krizës politike gjatë vitit 2016 dhe 2017, zgjedhjet lokale të vitit 2017 u shtynë dhe u mbajtën në tetor. Këto zgjedhje lokale e ndryshuan në mënyrë drastike raportin e vendeve për kryetar komune mes dy partive më të mëdha politike, VMRO-DPMNE dhe LSDM. Koalicioni i udhëhequr nga LSDM fitoi 57 vende për kryetar komune, që është 53 më shumë se zgjedhjet e mëparshme të v. 2013. Ndërsa, koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE fitoi 5 ulëse për kryetar komune, përkatësisht 51 më pak se në zgjedhjet e kaluara të v. 2013. BDI fitoi 10 vende për kryetar komune, që është 4 më pak se në zgjedhjet e kaluara të v. 2013. Partia politike Aleanca e Shqiptarëve, e cila si subjekt i veçantë politik mori pjesë për herë të parë në këto zgjedhje lokale, fitoi 3 ulëse për kryetar komune, ndërkaq, nga një kryetar komune fituan: BESA, PDSH dhe DPT, ndërsa 3 vende për kryetar komune u takuan kandidatëve të pavarur.

Për sa i përket ndryshimeve ligjore në Kodin zgjedhor të RMV përkitazi me zgjedhjet e shtata lokale të v. 2021, në periudhën nga zgjedhjet e fundit lokale të vitit 2017 deri në zgjedhjet e planifikuara për 17 tetor 2021, u miratuan disa ligje të reja dhe ndryshime në legjislacionin ekzistues. Në periudhën e kaluar janë bërë disa ndryshime lidhur me dispozitat e Kodit Zgjedhor. Ndryshimet kanë të bëjnë me organet zgjedhore shtetërore, financimin e fushatës politike, pjesëmarrësit në fushatë, si dhe dispozitat ligjore të Ligjit për shërbimet

mediatike audiovizive dhe miratimin e ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit.

Kodi Zgjedhor në 2021 u ndryshua dy herë, në prill dhe shtator 2021. Me ndryshimet u rregullua mënyra e votimit me dhe pa pajisje teknike dhe u rregullua mënyra e përcaktimit të identitetit të votuesit në procedurën e votimit me gjurmë gishtash. Gjithashtu, janë ndryshuar afatet lidhur me procedurën për mbrojtjen e të drejtës së votës dhe është përcaktuar mënyra e votimit në rast pandemie.

Për sa i përket rezultateve të zgjedhjeve të shtata lokale të v. 2021 u konstatua se:

Në të dy raundet e zgjedhjeve lokale numrin më të madh të ulëseve për kryetar komunash e fitoi VMRO-DPMNE e cila fitoi në 42 komuna, LSDM fitoi 16 mandate, BDI 11, dy kryetarë komunash fituan BESA, si dhe koalicioni Aleanca për Shqiptarët dhe Alternativa dhe një GROM dhe koalicioni për ndryshimin e LDP/DOM, ndërsa 3 ulëse për kryetar komune u takuan kandidatëve të pavarur në komunat e Kumanovës, Debarcës dhe Qytetit të Shkupit, me atë që pas zgjedhjeve Kryetari i Komunës së Studeniçanit i PDSH-së kaloi në radhët e Aleancës për Shqiptarët.

Për zgjedhjen e këshilltarëve lokal në komuna, VMRO-DPMNE doli e para duke fituar gjithsej 469 vende në këshille, LSDM 402, BDI 167, Koalicioni Aleanca për Shqiptarët dhe Alternativa fitoi 81, Levica fitoi 49, BESA 36, Koalicioni "Të vendosur për ndryshim" fitoi 29, DPTM fitoi 17, PDSH fitoi 9, lista e këshilltarëve të BDI-së dhe Aleancës për Shqiptarët dhe Alternativës, me të cilën këto parti performuan së bashku në komunën e Çashkës fitoi 4 vende këshilltarësh, TMRO: 3, GROM: 2, SRM: 2, PDT: 2, DNET: 2 dhe nga një këshilltar fituan: DSR, Maqedonia e Bashkuar, Podem, BDS, DDPS dhe "Rom-Romeske". Ndërkaq, kandidatët e pavarur fituan gjithsej 67 vende në këshill, nga të cilat: "Për Kumanovën tonë" fitoi 8 vende, "Shansi për Qendrën" - 3, "Ndryshe" në Komunën e Manastirit fitoi 3 vende, "Qyteti i Gjelbër Njerëzor" në Këshillin e Qytetit të Shkupit – 2; "Për mbrojtjen e Karposhit" - 2, "Më mirë për Tetovën" - 2, "VJEN E - Fronti kundër minierës dhe ndotësve të mjedisit" fitoi nga një përfaqësues në Këshillat komunalë Novosellë, Bosilovë dhe Strumicë.

Për zgjedhjen e këshilltarëve në qytetin e Shkupit, VMRO-DPMNE ka fituar 79.622 vota (34,6%), LSDM 53.354 (23.2%), BDI 26.379 (11.5%), Levica 20.346 (8,9%), Aleanca për

Shqiptarët dhe Alternativa 11450 (5%), Të vendosur për ndryshim LDP-DOM 9324 (4%) dhe Qyteti i Gjelbër Human 9230 (4%). Rrjedhimisht, nga gjithsej 45 këshilltarë në Këshillin e Qytetit të Shkupit, VMRO-DPMNE fitoi 18, LSDM 12, BDI 5, Levica 4 këshilltarë. Koalicioni Aleanca për Shqiptarët dhe Alternativa, Koalicioni “Të vendosur për ndryshim” dhe “Qyteti i Gjelbër Human” kanë nga dy këshilltarë.

Ndërkaq, në garën për Kryetar të Qytetit të Shkupit në raundin e dytë fitoi kandidatja e pavarur por e mbështetur nga VMRO-DPMNE dhe ASH-A, Danella Arsovska përballë Petre Shilegovit të LSDM-së.

Lidhur me vlerësimin e këtyre zgjedhjeve Misioni OSBE/ODIHR theksoi se zgjedhjet u mbajtën në frymë konkurruese dhe liritë themelore u respektuan gjerësisht. Megjithatë, në deklaratë thuhet se mangësitë e shumta në kuadrin ligjor nënvizojnë nevojën për një reformë gjithëpërfshirëse të sistemit zgjedhor. Vihet re se partitë kryesore parlamentare gëzojnë avantazhe sistematike, veçanërisht në aspektin e ndarjes së burimeve publike për fushatë parazgjedhore. Gjithashtu thuhet se zbatimi i vonuar i identifikimit biometrik të votuesve ka krijuar sfida shtesë në zhvillimin e këtyre zgjedhjeve. Miratimi i një sërë ndryshimesh në Kodin Zgjedhor pa debat publik apo konsultim me palët kryesore të interesuara në lidhje me këto zgjedhje vlerësohet si në kundërshtim me praktikën ndërkombëtare. Në këto zgjedhje u përdor për herë të parë identifikimi biometrik i zgjedhësve pa kryer një projekt pilot apo testim. Sipas deklaratës së OSBE/ODIHR-it, korniza e shkurtër e zbatimit e pengoi KSHZ-në të miratonte menjëherë aktet nënligjore, procedurat, trajnimin dhe edukimin e votuesve. Megjithatë, rastet me retorikë negative ndikuan në atmosferën e përgjithshme dhe partitë kryesore sulmuan njëra-tjetrën. Procesi i votimit në vendvotimet e vizituara u vlerësua si i mirëorganizuar, transparent dhe paqësor me incidente të izoluara dhe në disa raste me shkelje të fshehtësisë së votimit.

Nga ana tjetër, për sa i përket pjesëmarrjes së ulët të votuesve në zgjedhjet e shtata lokale të v. 2021, këto zgjedhje konfirmuan rregullin e pashkruar në Ballkanin Perëndimor se sa më të larta të jenë zgjedhjet hierarkike aq më e lartë është pjesëmarrja. Arsyeet pse në këto zgjedhje lokale pati një pjesëmarrje historikisht më të ulët se në të gjitha zgjedhjet lokale të mbajtura që nga pavarësia e Maqedonisë së Veriut, duhet kërkuar në faktorët si vijon: interesi i

dobët i qytetarëve për politikat lokale; njohuri të pamjaftueshme të kandidatëve për kryetarë komunash për përmbajtjen e politikave lokale; besimi i ulët i qytetarëve në organet dhe institucionet e vetëqeverisjes lokale; sidomos në organizatat lokale të partive politike; niveli joadekuat i decentralizimit të qeverisjes lokale; një fushatë e zezë për të denigruar kundërshtarin, e cila ndikon shumë që votuesit të zhgënjehen nga politika në përgjithësi dhe të abstenojnë nga votimi; si dhe mungesa e temave reale lokale gjatë fushatës parazgjedhore, e cila ndikon në votimin e partisë politike dhe jo në votën e individit si kandidat për kryetar komune, por edhe emigracioni masiv luan një rol të madh sepse llogaritet se janë 500.000 qytetarë të larguar nga vendi deri më tani.

## BIBLIOGRAFIA

### Tekste universitare, publikime, artikuj, udhëzime, strategji, raporte, studime dhe burime juridike

- Kodi Zgjedhor (tekst i konsoliduar), version jozyrtar i përgatitur nga Shërbimi i Ekspertëve të Komisionit Shtetëror Zgjedhor (“Gazeta Zyrtare e RMV-së”, Nr. 40/06, 136/08, 148/08, 155/08, 163/08, 44/11, 51/11, 54/11, 142/12, 31/13, 34/13, 14/14, 30/14, 196/15, 35/16, 97/16, 99/16, 136/16, 142 /16, 67/17, 125/17, 35/18, 99/18, 140/18, 208/18, 27/19, 98/19, 42/20 dhe 74/21).
- Udhëzime për reklamat politike me pagesë për zgjedhjet lokale 2021. Agjencia për Shërbimet Mediale dhe Audiovizuale, 01.09.2021.
- Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve, Programi për zhvillimin e aktiviteteve zgjedhore për zhvillimin e zgjedhjeve për anëtarët e këshillave komunalë dhe këshillin e qytetit të Shkupit dhe për kryetarët e komunave dhe kryetarin e qytetit të Shkupit, 2021.
- Marko Pankovski; Nikolla Mihajlovski; Iva Naskova; Zdravko Stavrov, Manual për zgjedhjet lokale në Republikën e Maqedonisë së Veriut 2021, Fondacioni Konrad Adenauer në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe Instituti për Demokraci “Societas Civilis” – Shkup, shtator 2021.
- Ueb faqja zyrtare e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve të RMV-së, Rezultatet nga zgjedhjet lokale të tetorit 2021.
- Ueb faqet e partive politike dhe koalicionet pjesëmarrëse në zgjedhjet lokale të tetorit 2021 në RMV.
- Марко Панковски; Никола Михајловски; Ива Наскова; Здравко Ставров; Прирачник за локални избори во Република Северна Македонија 2021 година, Второ дополнето издание, Фондација Конрад Аденауер во Република Северна Македонија и Институт за демократија „Социетас Цивилис “-Скопје, декември 2021.
- Државна Изборна Комисија, Роковник за извршување на изборните дејствија за спроведување избори за членови на советите на општините и Советот на Градот



Скопје и градоначалници на општините и градоначалник на Градот Скопје, 2021 година.

- Државна изборна комисија, Упатство за начинот на утврдување на идентитетот на гласачот, Скопје, 2021.
- Закон за територијалната поделба на Република Македонија и определување на подрачјата на единиците на локалната самоуправа. „Службен весник на РМ“, 49/1996 од 14.9.1996.
- OSCE/OIDHR Office for Democratic Institutions and Human Rights. Former Yugoslav Republic of Macedonia Municipal Elections 10 September 2000. OSCE/OIDHR Election Observation Mission Final Report, Ѓарсаѐ, 2000.
- „Заев поднесе оставка од премиерската и партиската функција“, Deutsche Velle на македонски јазик, 31 октомври 2021.
- „ВМРО-ДПМНЕ обвинува за нерегуларности, но очекува добри резултати“, 360 степени, 17 октомври 2021.
- „Мицкоски – Најдобро би било власта да си замине на предвремени парламентарни избори“, Слободна Европа, 31 октомври 2021.
- „Ахмети: ДУИ со значителна предност во Тетово, Чаир, Кичево, Струга“, 360 степени, 17 октомври 2021.
- „ДУИ победи на локалните избори, предвремени парламентарни избори не се потребни, вели Османи“, Макпрес, 2 ноември 2021.
- „Села: Со уцени и притисоци го задржавме Гостивар, го освоивме Дебар“, 24инфо, 17 октомври 2021.
- „Таравари: Од утре преговори за нова влада“, Денешен.мк, 31 октомври 2021.
- Управен суд, Судски портал на Република Северна Македонија.
- Изјава за прелиминарни наоди и заклучоци на Мисија на набљудување на изборите на ОДИХР – прв круг на локалните избори, 17 октомври 2021.
- Изјава за прелиминарни наоди и заклучоци на Мисија на набљудување на изборите на ОДИХР -втор круг на локалните избори, 31 октомври 2021.
- Одлуки по приговори, Државна комисија за спречување на корупција, Скопје, 2021.

- Jeton Shasivari, E drejta kushtetuese, Furkan-ISM, Shkup, 2020.
- Bajrami, Dr., Arsim; Muçaj, Mr., Florent; E drejta kushtetuese, Fakulteti Juridik, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, Prishtinë, 2018.
- Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, (Teksti jo-zyrtar, i spastruar-për përdorim intern), përkthyer nga: Prof. Dr Kurtesh Saliu, Fakulteti juridik-UEJL, Tetovë, 2007.
- Силјановска, Г., Митков, В. Локална самоуправа, Магор, Скопје, 2004.
- Тодоровски, Илија; Петковска, Христова, Лидија; Јовевска, Аница; Стојанова, Весна; Сланинка Динева Мирјана; Драговиќ Аница, Функционирање на системот на локалната самоуправа во Република Македонија, Институт за социолошки и политичко-правни истражувања, Скопје, 2004.
- Благојевич, С., Локална самоуправа у теорији, компаративно искуство и пракса, Правни факултет, Ниш, 2003.
- Visar Morina; Florent Muçaj; Entela Nikaj; Jeton Shasivari; Luz Balaj, Vetëqeverisja lokale: Shqyrtime teorike dhe krahasimore, Konrad Adenauer Stiftung, Prishtinë; 2021.
- Ligji për qeverisje lokale, “Gazeta Zyrtare e RMV-së” nr. 05/16.